



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

**FAKULTETI I GJUHËVE KULZURAVE DHE KOMUNIMIT
KATEDRA E SHKENCAVE TË KOMUNIKIMIT**

PUNIM I TEZËS SË MAGJISTRATURËS

TEMA:

**STEREOTIPET DHE PARAGJYKIMET BRENDA ETNIVE NË REPUBLIKËN E
MAQEDONISË SË VERIUT**

MENTORI:

Doc. Dr. Demush Bajrami

KANDIDATJA:

Nertila Arifi ID: 121772

Shkup, 2019

Strukturimi i punimit

ABSTRAKTI

HYRJE.....	3
PËRSHKRIMI I PROBLEMIT.....	4
QËLLIMI I STUDIMIT.....	6

KREU I.

1. DIVERSITETI KULTUROR I MAQEDONISË SË VERIUT

1.1	Çka janë stereotipet dhe paragjykimet.....	8
1.1.1	Zhvillimi i stereotipeve.....	9
1.1.2	Kultura si pjesë e stereotipeve.....	10
1.1.3	A janë stereotipet dhe paragjykimet të vërteta?	10
1.2	Koncepti psikologjik i stereotipeve dhe paragjykimeve.....	12
1.3	Stereotipet etnike në komunikimin ndërkulturor.....	13
1.4	Ndikimi i nocionit të Ballkanit si stereotip.....	14
1.5	Ndikimi negativ i diversitetit kulturor në Maqedoninë e Veriut.....	15
1.6	Stereotipet kulturore dhe jotoleranca.....	16
1.7	Multikulturalizmi etnik.....	16

KREU II.

2. MARRËDHËNIA E SHQIPTARËVE ME MAQEDONASIT

2.1	Rritja e paragjykimeve dhe stereotipizimit në Maqedoninë e Veriut ndaj shqiptarëve.....	19
2.2	Përhapja e stereotipeve më të thella mes maqedonasve dhe shqiptarëve.....	20
2.3	Pse shqiptarët ndihen të diskriminuar.....	22
2.4	Përkufizimi i termit 'Siptari'.....	25
2.5	Përkufizimi i termit 'Shkie'.....	27
2.6	Religjioni si pjesë e stereotipeve të përbashkëta të shqiptarëve dhe maqedonasve.....	29

KREU III

3. MAQEDONIA E VERIUT NË SYTË E VENDEVE PERËNDIMORE

3.1	Reduktimi i paragjykitimit dhe stereotipeve mes etnive të Maqedonisë Veriore.....	31
-----	---	----

3.2	Maqedonia Veriore midis diversiteteve kulturore dha paragjytimeve.....	33
3.3	Aspektet deklarative kundrejt pamjes reale.....	33
3.4	Komunitetet e Maqedonisë së Veriut që bashkëjetojnë veç e veç.....	35

KREU IV

4. ANALIZA E ANKETËS

4.1	Ndikimi i mediave në forcimin e stereotipeve dhe paragjytimeve.....	38
4.2	Multikulturalizmi si proces i rëndësishëm në diversitetin kulturor.....	42
4.3	Konceptet e rëndësishme të shumëgjuhësisë.....	43
4.4	A duhet nxënësit të mësojnë gjuhën e njëri-tjetrit.....	44
4.5	Maqedonasit dhe turqit.....	47
4.6	Maqedonasit dhe shqiptarët.....	50
4.7	Maqedonasit dhe romët.....	51

KREU V

5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Përmbledhje

Ky punim ka për qëllim të japë një përshkrim të qartë rreth stereotipeve dhe paragjykimeve në Maqedoninë e Veriut. Duke u bazuar në literaturën mbi stereotipet dhe paragjykimet janë bërë përpjekje që të japë një përshkrim se si këto dy fenomene kanë lënë një impakt negativ në shoqëri.

Sot, nuk është aspak e habitshme pse bashkësitë etnike në Maqedoninë e Veriut janë shpesh të stereiotipizuara në bazë të paragjykimeve të njëri-tjetrit por edhe në bazë të paragjykimeve të pjesës tjetër të Ballkanit Perëndimor. Mbi të gjitha, stereotipet janë zhvilluar edhe më së shumti me krijimin e idesë se 'ai' ose 'ajo' është "tjetri" dhe nuk është i/e "jona" (njeriu ynë). Me anë të metodave dhe teknikave të ndryshme është grumbulluar materiali faktografik dhe i njëjti është seleksionuar, analizuar dhe interpretuar me një qasje kreative dhe kritike kundrejt problemit.

Korniza teorike e stereotipave, paragjykimet dhe hulumtimeve mbi këto tema tregojnë se stereotipet në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë zhvilluar në lidhje me rrethanat socio-politike ku stereotipet janë përdorur për një kohë të gjatë dhe ende problemi vazhdon të thellohet edhe më shumë.

Ky hulumtim përcakton lidhjet kyçe të stereotipeve midis ndikimeve të brendshme të një jetese shumë vjeqare, në veçanti distancës kulturore, paragjykimeve, stereotipeve dhe mundësitë për të rregulluar në mënyrë më efikase ndërveprimet e tyre me këto sfida. Hulumtimi diskuton dhe qartëson arsyet dhe mënyrat se si stereotipet ndikojnë në menaxhimin e një marrëdhënie jo të mirëfilltë mes etnive dhe çfarë pasoja ka kjo në jetën multikulturore në këto rrethane por edhe se si ndikon kjo tek qytetarët e Maqedonisë së Veriut në jetën e përditshme.

Fjalët kyçe: Stereotip, paragjykim, diskriminim, komunikim, etni, distancë kulturore

Abstract

This paper aims to give a clear description of stereotypes and prejudices in northern Macedonia. Based on the literature on stereotypes and prejudices, efforts have been made to provide a description of how these two phenomena have left a negative impact on society. Today is not surprising at all why ethnic groups in North Macedonia are often stereotyped on the basis of one another's prejudices, but also on the basis of the prejudices of the rest of the Western Balkans.

Above all, stereotypes have been developed even more with the idea that 'he' or 'she' is 'the other' and is not 'ours' (our people). Through different methods and techniques, factum material will be collected and the same will be selected, analyzed and interpreted with a creative and critical approach. The theoretical framework of stereotypes, prejudices and research on these topics show that stereotypes in the North of Macedonia have been developed in relation to socio-political circumstances where stereotypes have been used for a long time and still the problem continues to deepen even more.

This research determines the main stereotype links between the inner influences of a multi-year lifestyle, in particular the cultural distance, prejudices, stereotypes, and opportunities to better address their interactions with these challenges. The research discusses and clarifies the reasons and the ways in which stereotypes affect the management of an improper relationship between ethnicities and what is the consequence of this in the multicultural life in these circumstances, but also how it affects the citizens of northern Macedonia in everyday life.

Keywords: Stereotype, prejudice, discrimination, communication, ethnicity, cultural distance

Апстракт

Целта на овој труд е да се даде едно јасно објаснување во врска со стереотипите и предрасудите во Северна Македонија. Базирано на литературата за стереотипите и предрасудите се направени напори да се даде објаснување како овие две феномени имаат оставено едно негативно влијание во општеството.

Денес не е воопшто изненадувачки зошто етничките групи во Северна Македонија се често стереотипизирани базирано во предрасудите еден за друг но исто така и предрасуди за другиот ден на Западниот Балкан. Пред се, сите стереотипи се развиени уште повеќе со креирањето на идејата дека „тој„ или „таа„ е „другиот„ и не е „нашата/нашиот„ (нашиот човек).

Со различни методи и техники е собрани фактографски материјал и истиот е селектиран, анализиран и толкуван со креативен и критичен пристап кон проблемот. Теоретската рамка на стереотипите, предрасудите и истражувањата во врска со овие теми покажува дека стереотипите во Републиката на Северна Македонија се развиле во однос на социо-политичките околности каде стереотипите се користени долго време и проблемот продолжува да се продлабочува уште повеќе.

Ова истражување ги одредува клучните врски на стереотипите помеѓу внатрешните влијанија на еден повеќе годишен животен стил особено на културната дистанца, стереотипи и можностите да се решават на поефективен начин нивните интеракции со овие предизвици. Истражувањето ги разгледува и разјаснува причините и начините на кои стереотипите влијаат на управувањето со несоодветната поврзаност меѓу етничките групи и какви последици тоа има врз мултикултурниот живот во овие околности, но и како оваа влијае на секојдневниот живот на граѓаните на Северна Македонија.

Клучни зборови: стереотип, предрасуд, дискриминација, комуникација, етничка припадност, културна дистан

HYRJE

Kontributi i dhënë në këtë tematikë mjaft voluminoze tenton t'i sqarojë idetë e krijimit të stereotipeve dhe paragjytimeve mes etnive që jetojnë në Maqedoninë e Veriut. Njohja e stereotipeve dhe paragjytimeve në vete ngërthen procesin përmes të cilit individët, qeveritarët dhe shoqëria duhet të mësojnë të njohin më mirë njëri-tjetrin.

Koncepti i ndalimit të mos zhvillimit të stereotipave është i vështirë por jo i paarritshëm. Sigurisht ky proces kërkon shumë punë e vullnet nga të gjitha anët. Stereotipet dhe paragjykimet shpesh janë dy faktorët më të rëndësishëm që marrëdhënia mes maqedonasve dhe etniciteteve tjera (sidomos shqiptarëve) nuk është e mirë.

Shtetet e Ballkanit kanë histori të gjatë të antagonizmit dhe diversitetit (Todorova, 1997). Krijimi i shteteve të reja apo konsolidimi i kombeve të tyre bën që shtetet e Ballkanit të kenë konflikte të vazhdueshme. Situata e stereotipeve në Maqedoninë e Veriut ndaj maqedonasve dhe shqiptarëve e etnive tjera ka filluar shumë herët dhe për fat të keq, situata është ende e tensionuar. Faktorët kryesorë për krijimin e stereotipeve dhe paragjytimeve janë ato politike dhe ekonomike që shtynë konfliktet ndëretnike dhe kulturore. Stereotipet etnike duket se në thelb ndikojnë në nxitjen e konflikteve etnike, veçanërisht në faza fillestare latente. E sigurisht, një gjë e tillë nuk i mungon as Maqedonisë së Veriut.

Nga vetë fakti se stereotipet sjellin pas vete konflikte ndëretnike, roli i shtetit si faktor i rëndësishëm ekonomik është modifikuar në mënyrë të konsiderueshme, gjithmonë problemet kyçe kanë qenë stereotipizimi mes etnive të ndryshme, se si shfrytëzohet dhe korruptohet buxheti i shtetit dhe përse një etni është e diskriminuar më shumë se një etni tjetër.

PËRSHKRIMI I PROBLEMIT

Maqedonia e Veriut ndonëse ka shpëtuar nga stereotipet dhe paragjykimet nga vendet e tjera të Evropës, kjo nuk do të thotë se një shtet multietnik siç është Maqedonia e Veriut t'u shpëtojë aq lehtë stereotipeve dhe paragjykimeve nga vetë etnitë që jetojnë brenda këtij shteti.

Sipas Allport (1958), stereotipet janë hapi i parë drejt paragjykimeve. Shpesh herë ngatërrojmë stereotipet me paragjykimet, stereotipet janë të lidhur thellë në rrënjë. Paragjykimet janë ndjenja urrejtjeje për një grup të caktuar. Pavarësisht se stereotipet dhe paragjykimet janë shumë të përafërta me njëra tjetrën, përsëri në gjenezën e tyre ata ndryshojnë nga përmbajtja. Për shembull, stereotipet kanë të bëjnë me procesin fundamental të kategorisë sociale që është e influencuar në mendime, ndjenja dhe sjellje të njerëzve. Paragjykimet janë ndjenja më të thella të urrejtjes ndaj grupeve të ndryshme etnike, fetare apo gjinore. Stereotipet dhe paragjykimet janë shumë problematike sepse bashkë këto krijojnë diskriminimin, ku kjo e fundit është ndjenjë e paarsyeshme negative ndaj personave që nuk i përkasin grupit tonë. Diskriminimi është një problem i madh shoqëror sepse është kaq i përhapur, merr kaq shumë forma dhe ka efekte të tilla negative në kaq shumë njerëz.

Në përgjithësi stereotipet etnike në Ballkan janë të rrënjosura thellë në historinë e të së kaluarës dhe asaj të tashmes. Gjithashtu stereotipet ballkanike nga vetë njerëzit e Ballkanit janë thelluar më së shumti gjatë fazës kur janë themeluar vendet përkatëse të Ballkanit, ky proces ishte i gjatë dhe filloi gjatë pushtimit osman dhe që nga lufta Austro-Hungareze. Stereotipet etnike në territorin e ish-Jugosllavisë janë ngulur thellë në historinë e largët të këtyre regjioneve. Ndërsa mendohet se stereotipet në mes këtyre regjioneve kanë ekzistuar edhe më herët se shekulli XIX. Maqedonia e Veriut ka një histori të gjatë të paragjykimeve dhe stereotipeve nga vendet tjera të Ballkanit Perëndimor.

Pastaj edhe mungesa e kontakteve me njëri tjetrin bëri që etnitë të ishin më të izoluar me njëri tjetrin, grupet etnike filluan shpejt për t'i identifikur grupet tjera etnike me epitetin 'të tjerët' dhe për këtë arsye qëllimi i këtij hulumtimi është për të zbërthyer epitetin 'të tjerët'.

Neofotistos (2004) përshkruan prezencën e stereotipeve negative mes maqedonasve dhe shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. Duke u bazuar në punën në terren të Neofotistos nga marsi 2000 deri në gusht të vitit 2001 në Çair, ai thekson se etiketimi i shoqërisë maqedonase si "etnikisht të ndara" dhe tensionet shoqërore si "etnike" sfidon negociatat për

tension si pjesë e jetës së përditshme dhe tregon një dështim të thellë për të kuptuar dinamikën sociale dhe çështjet e ndërlikuar të jetës së përditshme në Maqedoni.

Megjithëse parimet e të drejtave të njeriut janë të koduara në ligjin maqedonas, aplikimi i tyre mbetet selektiv dhe jo i plotë. Ky është pjesërisht rezultat i presioneve politike dhe ekonomike nga Ballkani jugor, si dhe traditat komuniste të vendit. Shpesh herë, qeveria maqedonase ka qenë përgjegjëse për shkeljen e të drejtave të qytetarëve të saj. Në këtë rast vlen të përmendet që shkelje të të drejtave të njeriut ka pasur më shumë ndaj etnive tjera përpos maqedonasve, kjo ka bërë që etnitë në Maqedoninë e Veriut të mos kenë një marrëdhënie të mirëfilltë përshkak të stereotipeve të krijuar vite më parë. Siç dihet tashmë Maqedonia e Veriut ka një numër të madh të grupeve të vogla që jetojnë në këtë shtet si shqiptarët, turqit, serbët, maqedonasit myslimanë dhe vllahët. Të gjithë këta pa asnjë lloj përjashtimi kërkojnë më shumë të drejta se çka kanë marrë dhe gjithashtu ankohen për nivelin e lartë të diskriminimit e të stereotipeve dhe pse maqedonasit janë në pedestal gjithmonë. Shumë prej qytetarëve të Maqedonisë së Veriut kanë ankesa drejt qeverisë që në vend se ta përmirësojnë jetën e qytetarëve të thjeshtë, qeveritarët mundohen edhe më shumë të forcojnë urrejtjen dhe stereotipet mes etnive të ndryshme në Maqedoninë e Veriut.

QËLLIMI I STUDIMIT

Është thelbësore që të vihet theksi i duhur në nivelin e lartë ku duhet të jepet një mesazh i qartë dhe efektiv se stereotipet dhe paragjykimet brenda etnive të Maqedonisë së Veriut duhet të merren seriozisht, sepse sa më shumë që paragjykojmë njëri-tjetrin aq më

shumë nuk do të kemi mundësi të njihemi me njerëzit me të cilët bashkëjetojmë. Paragjykimet dhe stereotipet sjellin rreziqe të mëdha ku ballafaqohen qeveritarë, institucione dhe njerëz të rëndomtë në jetën e përditshme.

Këto dy problematika të rëndësishme në Republikën e Maqedonisë kanë pasur vështrime të limituara përgjatë gjithë këtyre viteve. Qëllimi i këtij studimi është referuar në disa hulumtime:

- *Fred Abrahams me temën “A Threat to ‘Stability’: Human Rights Violations in Macedonia”,*
- *Vasiliki Nefotistos me temën “The Balkans’ Other within”: Imaginings of the West in the Republic of Macedonia, History and Anthropology” dhe po i njëjti autor me temën: “Beyond Stereotypes: Violence and the Porousness of Ethnic Boundaries in the Republic of Macedonia, History and Anthropology”,*
- *Ulf Brunnbauer Me temën “Fertility, families and ethnic conflict: Macedonians and Albanians in the Republic of Macedonia, 1944–2002 , Nationalities Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity” etj.*

Konstatimet mbi vështrimet e këtyre punimeve cilësore, kanë sjellë në konkretizimin e idesë që Maqedonia e Veriut ka shumë punë për të bërë nëse do të dojë të integrohet në Bashkimin Evropian. Pjesa e stereotipeve ndërmjet etnive bën që të mos ketë zhvillim ekonomik dhe kulturor dhe për këtë arsye një studim i këtij lloji është i nevojshëm.

Elaborimi i këtij studimi synon t’u japë lexuesve njohuritë e përgjithshme dhe të nevojshme rreth stereotipeve dhe paragjykimeve ndërmjet etnive në Maqedoninë e Veriut sidomos për të kuptuar edhe më shumë rreth stereotipeve në marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe maqedonasve. Pra, qëllimi i hulumtimit është i fokusuar në marrëdhënien e maqedonasve me etnitë tjera me fokus më të madh në atë me shqiptarët.

6. DIVERSITETI KULTUROR I MAQEDONISË SË VERIUT

Maqedonia e Veriut e vendosur në mes të Ballkanit, është një shtet i vogël i miksuar me etnitete të ndryshme. Grupet etnike në Maqedoninë e Veriut nuk kanë qenë të pakta.

Ndër grupet etnike përfshihen romët, turqit, shqiptarët, grekët, bullgarët, vllehët dhe maqedonasit. Etniteti që luan rol të rëndësishëm janë maqedonasit me 64% të popullsisë, shqiptarët rreth 25%, ndërsa turqit, romët, sërëbët dhe të tjerë përbëjnë pothuajse 10% të popullsisë në Maqedoni. Sa i përket turqve në Maqedoninë e Veriut njihen edhe si turq maqedonas, ky grup është grupi i tretë më i madh etnik në Republikën e Maqedonisë së Veriut. "Sipas regjistrimit të vitit 2002, në vend jetojnë 77.959 turq, duke formuar një pakicë prej rreth 3.8% të popullsisë. Komuniteti formon një shumicë në Qendrën Župa dhe Plasnica."¹ Nga ky komunitet më së shumti jetojnë në komunën e Center Zupa dhe Plasnicës. Thuhet se ka edhe torbeshë, ku një numër i madh i tyre e konsiderojnë veten edhe si turq. Por, ka edhe turq që e identifikojnë veten si maqedonas apo shqiptar për të mos pasur stereotipe nga etnitë tjera. Gjithashtu sipas statistikave të vitit 2002, në Republikën e Maqedonisë Veriore popullsia prej 2,045,177 përbëhet nga rreth 64% maqedonas, 25% shqiptarë dhe 4% turq etnikë. Popullsia e mbetur është rome, serbe, vllehe ose boshnjake.²

Është e rëndësishme të ceket se shkolla e parë turke u hap në vitin 1944. Sot janë mbi 70 shkolla që ofrojnë mësim në gjuhën turke. Pra, turqit kanë pasur dhe kanë të drejta të shkollimit në Maqedoninë e Veriut dhe është parë se turqit tregojnë një interes të madh për shkollim. Ndërsa, sa u përket edhe maqedonasve muslimanë, ndryshe të njohur edhe si torbeshë, janë një grup shumë i vogël në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ata thuhet se kanë lidhje të forta me turqit që jetojnë po në të njëjtin vend sepse ndajnë të njëjtat besime fetare dhe tradita. Ndërsa torbeshët më së shumti jetojnë në fshatrat e Dibrës dhe në Komunën e Strugës ku një fshat i njohur si Labunishta, thuhet se u takon torbeshëve. Sigurisht edhe një pjesë e madhe jetojnë në vendet tjera të Maqedonisë Veriore, si në Gostivar, Shkup dhe Tetovë.

Sa i përket bullgarëve, ata gjithashtu përbëjnë një pjesë shumë të vogël të popullsisë në Maqedoninë Veriore ku më së shumti mund të gjinden në Strumicë. Ndërsa vllehët, po

¹ Republic of Macedonia State Statistical Office (2005), Census of Population, Households and Dwellings in the Republic of Macedonia, 2002

² Sipas regjistrimit 2002 ku qytetarët vetë deklarojnë përkatësinë e tyre në një grup etnik. Numrat e saktë sipas regjistrimit ishin si në vijim; Maqedonasit 64,18%, shqiptarët 25,17%, turqit 3,85%, romët 2,66%,

Serbët 1,7%, vllehët 0,48% dhe të tjerët 1,88%.

ashtu përbëjnë një përqindje shumë të vogël ku shpesh i shohim në Manastir, Krushevë dhe Shkup. Kurse sa i përket romëve, ku janë më shumë te stereotipizuar dhe të diskriminuar, ata përbëjnë më rreth 2/3% të popullsisë në Maqedoninë Veriore. Mendohet se numri është edhe më i madh se sa paraqesin statistikat. Shumë prej këtij komuniteti jetojnë në komunën e Suto Orizari, ose siç njihet ndryshe edhe si Shutkë, kjo komunë gjindet në Shkup. Në Shutkë gjuha zyrtare e komunës është gjuha e romëve por flitet edhe maqedonishtja. Është i vetmi vend në Maqedoninë e Veriut ku romët mund të flasin gjuhën e tyre. Romët, siç u përmend më herët janë shumë të diskriminuar dhe të paragjykuar nga etnitë tjerë dhe për këtë arsye roli i tyre në Maqedoninë e Veriut do të marrë një vëmendje të veçantë në këtë hulumtim.

Gjithsesi, ndryshe nga republikat e tjera ish-Jugosllave, Maqedonia e Veriut nuk ka ndjekur të njëjtin model lufte dhe konflikte etnike. Maqedonia e Veriut ka jetuar në paqe me shumicën e etnive që jetojnë dhe veprojnë në Maqedoni por këtu bëjnë një dallim marrëdhëniet midis maqedonasve dhe shqiptarëve që ka qenë gjithmonë të tensionuara. Për këtë arsye ky hulumtim bazohet më shumë në çështjen e këtyre etniteteve dhe pastaj me ato të grupeve të vogla që u përmendën më lart.

1.1 Cka janë stereotipet dhe paragjykimet?

Stereotipet janë mendime që dikush ka për grupe të ndryshme të individëve që nuk mund të thuhet saktësisht se pasqyrojnë realitetin ku ne jetojmë. Stereotipet gjithashtu mund të pasqyrohen si karikatura, të cilat janë si një fotografi e ekzagjëruar të veçorive të caktuara, duke e shtrembëruar personalitetin e një individi. Në tryezat tona familjare por edhe shoqërore, shpesh ndodh që të flasim për të tjerët pa i njohur personalisht ato, edhe kjo është një shembull i stereotipit. Stereotipet mund të dallohen menjëherë ne raste ku njerëzve u përshkruhen tipare të ndryshme për shkak të përkatësisë së tyre gjinore, etnike apo racore. Ne mund të hasim stereotipe nga më të ndryshmet. Për shembull, kemi stereotipe si:

- Nxënësit që shkruajnë bukur, janë të përgjegjshëm
- Gjermanët janë precizë dhe lakmitarë
- Britanezët e pëlqejnë çajin
- Qentë janë besnikë
- Dhuna vjen vetëm nga meshkujt e shtresës së ulët etj.

Shembujt që u përmendën më lartë duket qartë që janë stereotipe për shkak se ato bazohen në informata të kufizuara ose fakte të paverifikuara, janë të përgjithësuara dhe jo domosdoshmërisht të sakta. Ata vetëm nxjerrin në pah disa karakteristika të përgjithësuara të njerëzve, grupeve sociale apo komuniteteve, por neglizhojnë dallimet midis tyre dhe midis individëve.

Paragjykimet nuk konsiderohen si stereotipet sepse ata bazohen pikërisht në qëndrimet tona personale, emocionet dhe për më tepër nga urrejtja që ne kemi për dikë. Është e ditur se qëndrimi përbëhet nga tre komponentë: ajo kognitive, afektive dhe motivuese.

- Kongitivja ka të bëjë me njohjen që secili individ e ka përftuar mbi diçka ose ndaj ndonjërit.
- Komponenti afektiv ka të bëjë me emocionet dhe ndjesitë
- Komponenti motivues me qëllimin për sjellje ndaj ndonjërit ose ndaj diçkaje. (Gulevska, Mehmedi, & etj, 2015)

6.1.1 Zhvillimi i stereotipeve

Pothuajse të gjithë stereotipet janë pjesë e karakterit tonë dhe zhvillimit të personalitetit të një njeriu. Atë shpesh e shohim të zhvilluar në kulturë sepse është pjesë e spikatur e saj. Ne i shohim stereotipet në shumë mënyra të ilustruara si në televizion, shkollë, kontaktet me mësuesit dhe shoqërinë etj. Shpesh herë zhvillimi i stereotipeve mund të jetë i qëllimshëm por ndodh të jetë edhe pa dashje. Për shembull Katz and Braly (1933) të cilët ishin pjesë të studimeve klasike të kësaj fushe supozonin se stereotipet janë produkte të kulturave dhe këto stereotipe mund të zhvillohen vetëm nëse ato mbahen gjerësisht. Është paraparë sipas autorëve të ndryshëm se njerëzit kanë mënyra të përbashkëta të përpunimit të informacionit që sjellin stereotipe të caktuara.

6.1.2 Kultura si pjesë e stereotipeve

Për shkak se besimet dhe vlerat kulturore pranohen në përgjithësi, po ashtu pranohen edhe stereotipet. Zhvillimi i stereotipeve është shumë i lehtë të ndiqet nga fëmijët nëse atë stereotip e beson një grup i madh njerëzish sepse fëmijët nuk njohin kulturë tjetër. Sot,

stereotipet dhe paragjykimet janë zhvilluar aq shumë sa që shpesh pyesim veten: 'Nga i kemi marrë këto pritshmëri, ndjenja negative, paragjyqime për të tjerët kur as nuk i njohim mirë?' sepse këto vlera dhe besime shkaktojnë probleme dhe as nuk përpiqemi për të komunikuar me të tjerët, vetëm se ata nuk i përkasin grupit tonë, ne i dallojmë nga grupi jonë i ngushtë familjar ose shoqëror. Gjithashtu, njerëzit si qenie humane janë krijuar dhe gjithashtu krijuar të kulturës sonë.

"Mungojnë modele të sakta se si kulturat hynë në mendjet tona, dhe një mjegullsi e tillë na jep leje për të vendosur shumë më tepër pikëpyetje. Pra, kur thuhet dhe bëhet gjithçka, ne kemi dy kategori të mëdha dhe disi të përhapura të shpjegimeve se përse zhvillojmë stereotipe të caktuara. Ata mund të jenë produkte të kulturave ose nënkulturave tona, ose mund të prodhohen nga përvojat tona, të korruptuara ose të pastra. Për fat të mirë apo jo, këto shpjegime nuk janë reciprokisht ekskluzive" (Schneider, 2004).

Nëse shpesh ndeshemi me një stereotip që ka marrë një popullaritet në kulturën tonë atëherë është e vështirë për ta eliminuar. Por, ndodh edhe të eliminohen stereotipet dhe paragjykimet nëse nuk ndeshemi shpesh me to, apo ka shumë pak njerëz që e praktikojnë.

6.1.3 A janë stereotipet dhe paragjykimet të vërteta?

Në mënyrë të qartë, stereotipet janë reflektime të drejtpërdrejta të përvojave tona. Siç u përmend edhe më herët, ata mund të ndikohen nga kultura, familja e shumë faktorë tjerë. Na ndodh shpesh që ndonjë stereotip specifik të bazohet në kontakte të tërthorta me grupe relevante. Për paragjykimet është shumë e thjeshtë për të thënë se nuk janë të vërteta sepse ata bazohen më së shumti në ndjenja individuale të personave. Por, gjithashtu kemi edhe disa arsye pse stereotipat nuk janë të vërteta. Schinder (2004) supozon se një prej arsyeve mund të jetë se stereotipet më së shumti vijnë nga individë që besimet e tyre janë më të diktuara nga paragjykimet e tyre se sa e kundërta.

Gjithashtu shumë stereotipe duket se bazohen në pak përvoja të drejtpërdrejta dhe është e lehtë të hidhen në përfundimin se përgjithësimet e tilla duhet të jenë të pasakta. Mbi të gjitha, një prej arsyeve pse stereotipet janë të pasakta është se ata kanë sjellur konflikte midis njerëzve të racave, etnive të ndryshme e jo vetëm kjo, pavarësisht se ato mund të kenë elemente të së vërtetës. Kur stereotipizojmë, ne në mënyrë të drejtpërdrejtë ofendojmë një


grup të caktuar njerzish, e kjo bën që të kemi një arsye më shumë përse mos t'u besojmë stereotipeve.

“Saktësia apo e vërteta mund të thonë gjëra të ndryshme për njerëz të ndryshëm sepse ekzistojnë disa mënyra për të konceptuar dhe matur saktësinë. Në një nivel më praktik, pyetja në dukje thjesht nëse stereotipet janë të sakta rezulton të jetë jashtëzakonisht vështirë për t'u përgjigjur.” (Schneider, 2004)

Ndoshta nuk mund ta dimë sa të pavërteta ose të vërteta janë stereotipet dhe paragjykimet por të paktën shumica prej nesh e kanë një ide të stereotipeve të përgjithshme. Për shembull, mendojmë për zezakët se janë të dhunshëm dhe të egër, por kjo vlen më shumë për njerëzit e papunë dhe të paarsimuar, ose zezakët janë shumë të mirë në sport, krejt malazezët janë përtacë etj. “Shpesh herë stereotipet janë të kushtëzuara shumë nga personi, koha dhe vendi” (Niemann & Secord, 1995). Nuk do të thotë që një kulturë ka stereotipe për një grup të caktuar njerëzish njësoj si një kulturë tjetër.

1.2 Koncepti psikologjik i stereotipeve dhe paragjykimeve

Psikologët social kanë shpenzuar përpjekjet thelbësore kërkimore duke studiuar këto



koncepte:

Komponenti kognitiv është stereotip ku bindjet pozitive ose negative i kemi në lidhje me karakteristikat e grupit social.

Përveç stereotipeve tona, ne gjithashtu mund të zhvillojmë paragjykime që paraqesin një

qëndrim negativ të pajustificuar ndaj një grupi të jashtëm ose ndaj anëtarëve të atij grupi të jashtëm. Paragjykimet mund të marrin formën e mospëlqimit, zemërimit, frikës, neverisë, sikletit dhe madje edhe urrejtjes - llojin e gjendjeve **emocionale** që mund të çojnë në sjellje të pahijshme. Stereotipet dhe paragjykimet që ne kemi dhe që ne i shfaqim faktikisht janë problematike, sepse ato mund të krijojnë sjellje të pajustificuara ndaj grupeve tjera që ne mendojmë se nuk na përkasin neve.³

“Hulumtimi psikologjik social ka zbuluar se stereotipet tona mund në disa raste të çojnë në ulje të performancës kërcënuese stereotipike që shkaktohen nga njohja e stereotipeve kulturore.” (Jhangiani , 2012)

Spencer, Steele dhe Quinn (1999) zbuluan se kur grave u kujtonin stereotipin (të pavërtetë) se "gratë janë të dobëta në matematikë", ata performonin më dobët në testet e matematikës sesa kur nuk u kujtonin stereotipin. Gjithashtu, ka hulumtime të tjera të ngjashme ku mund të shohim se sa keq mund të ndikojnë stereotipet tek individët përkatës, e ky ndikim mund të jetë edhe i pavetëdijshëm.

1.3 Stereotipet etnike në komunikimin ndërkulturor

³ <https://opentextbc.ca/socialpsychology/part/chapter-12-stereotypes-prejudice-and-discrimination/>

Emrat etnik abuziv, thëniet dhe sharjet ende përdoren sepse ruhen në mendjen e bartësve kulturorë dhe transmetohen nga brezi në brez. Ka pasur një supozim se mësimi i një gjuhe të huaj ishte një mjet i mirë për heqjen e stereotipeve. Gjithashtu, aktivitetet jashtë mësimore janë forma më të përshtatshme për t'u integruar në shoqërinë e njëri tjetrit.

Stereotipet etnike në komunikimin ndërkulturor janë të pranishme në jetën shoqërore të njerëzve të rëndomtë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Maqedonasit kanë stereotipe për shqiptarët dhe romët, shqiptarët për maqedonasit dhe romët e gjithashtu këto të fundit për shqiptarët dhe maqedonasit. Maqedonasit mendojnë për shqiptarët se janë vjedhës dhe kanë edhe barçoleta për këtë, të njëjtën gjë bëjnë edhe shqiptarët. Kjo ndihet në shkollë, aktivitetet jashtë shkollës, në punë dhe në çdo hapësirë ku ndodhen etnitë e ndryshme.

Ndryshe një stereotip mund të konsiderohet edhe kur një person paragjykon personin tjetër duke u bazuar në karakteristikat fizike. Është e habitshme se si etnitetet brenda Maqedonisë së Veriut njohin kush është maqedonas, kush shqiptar e kush rom etj. Ato thonë se bëjnë njohjen pa folur me tjetrin vetëm nëpërmjet fytyrës, të veshurit, të ecurit etj. Kjo është një tjetër paragjykim por që gjithmonë rezulton të jetë i vërtetë dhe kjo bën që marrëdhëniet të jenë edhe më të vështira sepse stepemi të komunikojmë me tjetrin. Stereotipet dhe paragjykimet ndikojnë si njerëzit mendojnë, veprojnë dhe sillen. Ata shprehen në mënyra të ndryshme, të cilat ndryshojnë sipas shkallës dhe pasojave të tyre. Çdo gjë mund të fillojë me diskutim kur një grup, zakonisht ai që mendon për veten si superior, duke bërë shaka për grupin tjetër ose duke shprehur urrejtje ndaj tij.

“Në shkollat e Republikës së Maqedonisë shumë zëshëm manifestohen stereotipet. Kjo ndodh me nxënësit në shkollat njëgjuhësore dhe shumë gjuhësore kur nuk kanë kurrfarë njohje të kulturave të ndryshme, për shkak të mungesës së çfarëdo lloj aktiviteti të përbashkët.” (Gulevska, Mehmedi, & etj, 2015). Mësimdhënësit dhe nxënësit në shkollat që janë të përzier me etnitete të ndryshme, nuk zhvillojnë asnjë lloj komunikimi. Personalisht e kam kryer shkollën e mesme në gjimnazin “Drita”, në Kërçovë, ku për katër vite rresht, maqedonasit dhe shqiptarët mesonin me turne dhe ende ky lloj mësimi zhvillohet në Kërçovë dhe në shumë qytete tjera.

1.4 Ndikimi i nocionit të Ballkanit si stereotip

Gjeografi i mirënjohur Jovan Cvijic në vitin 1918 botoi një libër me titullin: Gadishulli Ballkanik.⁴ Ky libër i ishte kushtuar Ballkanit, duke pohuar një lloj identiteti në botën e ballkanit. “Një pjesë e mirë e librit merret me çështjen e emrit që i janë vënë gadishullit përgjatë historisë. Për shembull, “ai i “Ballkanit” tërheq në mënyrë të veçantë vëmendjen nga fakti i ambiguitetit dhe i karakterit të tij emblemantik: fjalë turke që do të thotë “mal”, ajo përdoret nga udhëtarët si shenjuese e urke që do të thotë “mal”, ajo përdoret nga udhëtarët si shenjuese e vargmalit Haemus i gjeografëve të Antikitit, i cili gjendet në Bullga-argmalit Haemus i gjeografëve të Antikitit, i cili gjendet në Bullgarinë e sotme, atë që popullsia sllavofone që banon tashmë aty e quan me emrin Stara Planina, ‘Mali i Vjetër’.” (De Rapper & Sintès, 2015)

Për më tepër, Cvijic thotë se Gadishulli i Ballkanit doli nga një konceptim i gabuar i relievit të Gadishullit, sipas tij këto gabime e kanë zanafillën në Antikitet dhe në periudhën turke. Por, falë këtyre gabimeve, ky emër merr një vëmendje të veçantë. Që kur kanë filluar këto cilësime të Ballkanit si një zonë gjeografike dhe kulturore nuk është ndalur së diskutuari.

Sipas Maria Todorova (1997) kuptimi i ri i fjalës ballkanizim ishte copëtim, gjë që e kishin theksuar edhe fuqitë e mëdha, nënkuptonte një mënyrë jetese të bazuar në prapambetje, primitivizëm dhe barbarizëm. Ballkani ka qenë gjithmonë me shumë stereotipe dhe ndonjëherë është interesant se si këto stereotipe ndryshojnë shumë nga njëra tjetra në shtetet ballkanike. “Gjatë historisë Ballkani dihet si zona më problematike e kontinentit evropian dhe përmendet si ‘fuçi baruti’” (Turbedar, 2019). Shpeshherë vendet perëndimore kanë paragjykimet se si e perceptojnë Ballkanin, në shumicën e rasteve ata e shohin Ballkanin si një rajon me dhunë dhe vrazhdësi. Kurse vetë vendet e Ballkanit nuk duan që të identifikohen në këtë mënyrë dhe e konsiderojnë veten të civilizuar. “Për herë të parë rajonin me këtë emër e ka emërtuar në vitin 1809 gjeografi gjerman August Johan Cojne (August Johann Zeune) duke u frymëzuar nga emri i Maleve Ballkan, që e ndajnë Bullgarinë horizontalisht në dy pjesë. Më pas fjala Ballkan filloi të përdoret gjerësisht si emër i një rajoni.” (Turbedar, 2019)

Perceptimi i Ballkanit tek vendet perëndimore siç u përmend edhe më herët nuk përmban dukuri pozitive, por përkundrazi, vetëm dukuri apo elemente negative. Mbi të gjitha,

⁴ J. Cvijić, La péninsule balkanique (1918)

ky rajon kurrë nuk është parë si pjesë e civilizimit perëndimor, as nuk është përafuar. “Udhëtarët perëndimorë që kanë shëtitur Ballkanin në shekullin e 19-të, në udhëpërshkrimet e tyre rajonin në përgjithësi e kanë përshkruar si të ndryshëm, të çuditshëm dhe tepër të pa civilizuar.” (Turbedar, 2019)

1.5 Ndikimi i diversitetit kulturor në Maqedoninë e Veriut

Sipas Kushtetutës, “qeveria ka detyrimin të përmbushë të drejtën për arsim për të gjithë dhe të mos diskriminojë identitetin etnik apo gjininë” (Klaudjo, 2017). Mësimdhënësit gjithashtu mund të ndikojnë në ndarjen e arsimit. Sipas OSBE (2010b) “raportojnë se mësimdhënësit janë një nga faktorët për zhvillimin e marrëdhënieve ndëretnike në mesin e studentëve. Kështu, kur mësuesit sjellin në klasë paragjykimet e tyre personale, ata ndikojnë në perceptimet dhe marrëdhëniet e nxënësve.” (Klaudjo, 2017, f. 487). Përsëri sipas OSBE një numër të madh i nxënësve raportojnë se mësuesit e tyre bëjnë komente të papërshtatshme për nxënësit e etnive tjera. Disa nga vërejtjet më të zakonshme ndodhin mes mësuesve maqedonasë kundrejt shqiptarëve dhe nga mësuesit shqiptarë kundrejt maqedonasve. Për fat të keq, ky është një reflektim i të shprehurit ndjenjat negative, ku edhe më tepër i përkeqësojnë marrëdhëniet mes nxënësve dhe ndjenja e urrejtjes rritet më shumë tek nxënësit. Në një studim tjetër të bërë nga OSBE u tregua se ndërjegjësimi i grupeve të tjera etnike ndodh në moshën gjashtë vjeçare, ndërkohë që ndjenjat pozitive ose negative fillojnë të zhvillohen në moshën dhjetë vjeçare. Përzierja e nxënësve nëpër klasa është shumë rëndësishme, ndonjëherë ndodh të ketë ndikim negativ por ndodh që të ketë ndikim pozitiv. Ndërsa përzierja e nxënësve në shkolla mikse nuk ka ndikim të mirëfilltë për shkak se nxënësit të etnive të ndryshme shumë rrallë takohen me njëri-tjetrin.

Shpesh herë ndodh të mburremi kur dalim nëpër trajnime, konferenca dhe nëpër mbledhje të rëndësishme, me krenari themi se shteti ynë është një shtet multi-etnik dhe diversiteti kulturor është një gjë që na karakterizon. Mbi të gjitha, politikanë shqiptarë dhe maqedonasë nëpër shtyp thonë se edhe në politikë ka përzierje të etnive të ndryshme në një parti politike. Por, në fakt kjo ndodh shumë rrallë në Maqedoninë e Veriut.

Gjithsesi, etnitë e ndryshme në Maqedoninë e Veriut ankohen edhe për gjërat bazike që ata nuk i kanë. Për shembull, ka mungesë të arsimtarëve dhe teksteve shkollore në gjuhën

amtare, mungesë në promovimin e vlerave kulturore dhe kushte jo të mira për kultivimin e identitetit kulturor të këtyre etnive.

1.8 Stereotipet kulturore dhe jotoleranca

Pothuajse në çdo vend të botës ekzistojnë stereotipe kulturore, ata mund t'i gjejmë në forma të ndryshme të shakave, anekdotave, nëpërmjet fjalëve ej. Stereotipet kulturore janë të dëmshme për një komunikim të mirëfilltë mes palëve të përfshirë në stereotip ku shkaktohet si pasojë e kësaj edhe intoleranca. Kulturat që u përkasin traditave të ndryshme janë veçanërisht të prirur për stereotipet reciproke.

1.9 Multikulturalizmi etnik

Me multikulturalizëm nënkuptojmë bashkëjetesë me shumë kultura në të njëjtën kohë. Promovimi i kulturave të ndryshme në një shtet është qëllimi kryesor për të arritur interesa dhe vlera të barabarta në të gjitha sferat e jetës. "Multikultura orientohet kah ruajtja e rrënjëve të traditës, historisë dhe trashëgimisë së secilit grup duke tejkuluar pengesat, stereotipet dhe paragjykimet ndaj grupeve të caktuara etnike." (Idrizi, 2017, f. 323) Multikulturalizmi ka një rol të rëndësishëm sepse ruan vlerat dhe traditat e gjithë etniteteve pa përjashtim. "Në pjesën më të madhe të letërsisë post-multikulturore, multikulturalizmi karakterizohet si një festim i mirëfilltë të diversitetit etnokulturor, duke i inkurajuar qytetarët që të njohin dhe të përqafojnë traditat, muzikat dhe kuzhinat që ekzistojnë në një shoqëri multi-etnike." (Will, 2012, f. 4)

Në Maqedoninë e Veriut multikulturalizmi është i përfshirë gjithandej sidomos në arsim. "Multikulturalizmi në arsim paraqet bazë për mirëkuptim reciprok dhe bashkëjetesë në një vend të përbërë nga etnitet dhe gërshetime të kulturave e religjioneve të ndryshme, në një pluralizëm kulturor në hapësirë të caktuar, në një mozaik të shoqërisë në të cilën jetojnë pranë njëri tjetrit etnikume të ndryshme me gjuhë dhe kultura të ndryshme." (Idrizi, 2017). Multikulturalizmi i duhur arrihet përmes komunikimit ndërkulturor, tolerancës ndaj njëri-tjetrit, marrëveshjet midis etnive të ndryshme, mirëkuptimit dhe vlerësimit. Këto vlera paraqesin parime bazike për të pasur një bashkëjetesë më të mirë sepse vetëm me bashkëjetesë të duhur do të mundemi të kemi komunikim të duhur. Sigurisht, ky lloj

komunikimi ndikon edhe në një arsim multikulturor ashtu siç duhet dhe jo ashtu siç jemi mësuar ta shohim nëpër shkolla. Sipas Idrizit (2017) “arsimi multikulturor zhvillon shkathtësi për sjellje, komunikim, tolerancë dhe mirëkuptim me pjesëtarë të grupeve etnike të ndryshme, me qëllim që të tejkalohet nyja kulturore e cila mund të pengojë fitimin e arsimit të nevojshëm.” (f. 323) Kjo do të thotë se elementet e multikulturalizmit duhet të jenë pjesë e çdo niveli arsimor. Një parim tjetër i multikulturalizmit është se ne duhet t’i mësojmë fëmijëve së pari për kulturën dhe historinë tonë pastaj t’i vetëdisojmë ata për identitetet tona nacionale, kjo i ndihmon ata për t’i respektuar më shumë dallimet ekzistuese.

Të mësosh në një ambient multikulturor paraqet një proces të rëndësishëm në formimin e individëve ku njohim kulturën dhe shoqërinë që na rrethon. E kjo është një mënyrë e mirë për një bashkëjetesë në paqe sepse vetëm me mirëkuptim dhe respekt do të mund të jetojmë në demokraci. Sigurisht, sot të gjithë po përpiqen për përfshirjen e multikulturës në çdo proces jetësor pasi që vetë procesi i multikulturalizmit është tendencë e globalizimit pasi që nëse ne nuk jemi në gjendje të respektojmë kulturën e etnisë që jeton me ne atëherë nuk do të mund të respektojmë edhe kulturat e tjerë që nuk i njohim nga afër. “Arsimi multikulturor promovon arsimim të bazuar mbi respektin, barazinë, lirinë dhe mundësitë e barabarta për fitimin e shkathtësive dhe për rezultate pozitive në procesin arsimor.” (Idrizi, 2017, f. 324)

Sipas Benks-it (James A. Banks, 1999), ekzistojnë pesë dimensione të arsimit multikulturor në shkollë, që përbëjnë bazën e integritit të suksesshëm ndëretnik. Ato janë:

Integrimi i përmbajtjeve – përpunimi i lëndëve të ndryshme mësimore, ku këtu ndihmon me funksionimin e multikulturalizmit nëpërmjet nxitjes së shkathtësive dhe integritin multi-etnik.

Procesi i përfitimit të diturive – ky proces tashmë është i ditur sepse zhvillohet gjithmonë në shkollë. Me këtë lloj procesi nxënësit kanë mundësi të krijojnë mendimet logjike dhe kritike të tyre. “Në të vërtetë, fjala është për atë se një tekst i njëjtë mund të interpretohet në mënyra të ndryshme nga ana e njerëzve të ndryshëm, varësisht nga fakti se çfarë paragjyimesh dhe qëndrimesh kanë, por edhe me çfarë dijetsh disponojnë.” (Idrizi, 2017, f. 326)

Reduktimi i paragjyimeve – ky proces është gjithashtu i rëndësishëm pasi që përzierja e etnive të ndryshme në një rreth ndihmon në reduktimin e paragjyimeve që ne kemi për të tjerët. Vetëm se kemi paragjyime për dikë, ajo e bën që komunikimi në çdo

mënyrë të jetë i vështirë për këtë arsye sugjerohet që reduktimi i paragjykimeve tek nxënësit të jetë në maksimum. “Paragjykimet ndryshojnë me shumë vështirësi, madje shpesh nuk ndihmojnë as nuk ndikojnë edhe argumentet ndaj tyre. Me forcën e argumenteve mund të ndikohet për mposhtjen e paragjykimeve dhe të stereotipeve nëpërmjet procesit të gjithmbarshëm edukativo-arsimor.” (Popova, 2015, f. 21)

Zgjidhja e konflikteve dhe ndërtimi i paqes⁵ - Ndërtimi i paqes është një term jo pak i dëgjuar, ku me këtë përpiqemi të tregojmë se duhet të jemi sa më shumë të vendosur për zgjidhjen e problemeve dhe për të vënë stabilitet në vend. “Jotoleranca ekzistuese rrjedh edhe prej asaj që nxënësit, arsimtarët dhe prindërit e grupeve të ndryshme etnike i llogarisin nxënësit e grupit “tjetër” për më të privilegjuar në një farë mënyre” (Beshka, 2009, f. 112). Në nivel demokratik, sistemi arsimor duhet sa më shumë ta promovojë multikulturalizmin si një proces të rëndësishëm për arsimim dhe të kontribuojë për një jetë sa më në paqe mes etnive që jetojnë në atë shtet. “Ndër qëllimet kryesore të arsimit në botën bashkëkohore, përveç tjerave është edhe arsimi në frymën demokratike në shoqëri” (Idrizi, 2017, f. 328).

2. MARRËDHËNIA E SHQIPTARËVE ME MAQEDONASIT

Përqindja e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut është pika kryesore e konflikteve midis shqiptarëve dhe maqedonasve. “Që kur erdhi në pushtet në vitin 1992, ish-Presidenti shqiptar Sali Berisha ka shprehur shqetësim për të drejtat e shqiptarëve etnikë në Maqedoni, ndonjëherë duke tërhequr kritika për ndërhyrje në punët e brendshme të Maqedonisë, por në përgjithësi duke mbajtur një pozicion të moderuar” (Abrahams, 1996, f. 26). Por, ish-presidenti shqiptar Berisha u mundua t’u përmbahet komenteve të tij pasi që mori kritika të mëdha nga Shkupi dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Më vonë, ai përsëri dha disa deklarata në lidhje me marrëdhënien e shqiptarëve në Maqedoni ku sipas Abraham (1996), qeveria shqiptare e Tiranës në vitin 1995, shprehu shqetësimin për mbylljen e universiteteve private në gjuhën shqipe në Tetovë. Ministria e jashtme lëshoi deklarata të forta në mbrojtje

⁵ Atanasoska, T. (2015). “Shkolla dhe misioni i saj si shtytës i ndryshimeve në shoqëri”, (Doracak: Pikëpamje teorike dhe praktike për zbatimin e integritit ndëretnik në fakultetet për arsimtarë). Shkup: Qendra maqedonase për edukim qytetar, f.59

të nismës e cila nxiti një përgjigje maqedonase që Shqipëria po ndërhynte në çështjet e saja të brendshme.

Në Maqedoninë e Veriut, gjuha shqipe është folur vetëm në vendet lokale qeverisëse ku shqiptarët zënë një vend të madh të popullsisë. Ku studentët nuk kishin gjuhën e tyre dhe duhej të udhëtonin për të studiuar. Shqiptarëve u janë mohuar të drejtat bazike si ata të garantuara në ligjin maqedonas dhe atë internacional. Veçanërisht, qeveria maqedonase duhet të marri hapa për të eliminuar diskriminimin në punësimin e shtetit.

Ilir Luma, anëtar i partisë politike “Prosperiteti Demokratik” në një deklaratë për *Human Right Watch/Helsinki* thotë: *Të gjithë liderët e institucioneve të shtetit dhe ndërmarrjeve janë maqedonas. Shqiptarët etnik aplikojnë për punë por shpesh herë pranohen rrallë, edhe në qoftë se maqedonasit janë më pak të kualifikuar. Në spitalin ku unë punoj (në Tetovë), atje janë rreth 1,350 të punësuar. Nga ata, më pak se 350 janë shqiptarë etnikë. Është fakt se maqedonasit paraqesin 15-20% në popullsinë e Tetovës.*⁶

2.1 Rritja e paragjytimeve dhe stereotipizimit në Maqedoninë e Veriut ndaj shqiptarëve

Hough Poulton bëri hulumtimin e maqedonasve në librin: *Who Are the Macedonians?* (Kush janë maqedonasit?). Ndër shumë çështjeve të shqyrtuara, ai bëri analizë të mirëfilltë mes marrëdhënieve të maqedonasve dhe shqiptarëve, turqve, vllahëve, romëve, torbeshëve (muslimanëve maqedonas) dhe egjiptianëve që jetojnë në Maqedoni. “Në Qershor 1981, në një përpjekje për të ndaluar rrjedhën në rritje të nacionalizmit në mesin e shqiptarëve, Komisioni i Kuvendit të Maqedonisë për marrëdhëniet ndëretnike mbështeti kërkesën e Marrëdhënieve të Odës Socio-Politike për një rishikim të planprogramit dhe teksteve shkollorë” (Poulton, 1995, f. 127). Gjithashtu, shumë orë u konsideruan për të mësuar maqedonisht nëpër shkolla shqiptare, në këtë mënyrë do të ndalonin idenë e të mos mësuarit fare gjuhën maqedonase tek shqiptarët. Ndërsa në Gusht të vitit 1981, Këshilli Pedagogjik Maqedonas në Shkup theksoi se ‘kishte mangësi në planprogramet, tekstet shkollorë të përdorura nga etniteti shqiptar në Maqedoni’.

⁶ Intervistë me Ilir Luma nga Human Rights Watch/Helsinki, Tetovë, 30 Qershor 1995

Sipas hulumtimit të Poulton (1995), një ligj në vitin 1985 në shkollat e mesme të Republikës së Maqedonisë Socialiste përcaktoi që klasat në gjuhën shqipe do të krijoheshin nëse 30 nxënës shqiptarë do të ishin regjistruar në atë klasë dhe nëse do të kishte mësues të kualifikuar. Ky ligj ishte shumë strikt ku rezultoi deri aty që klasat e nxënësve shqiptar të mbylleshin dhe t'i detyronin po këto nxënës të jenë pjesë e klasave mikse me maqedonasit. Kjo ishte e imponuar nga vetë qeveria e atëhershme maqedonase dhe ishte një ndër arsytet e rritjes së nacionalizmit shqiptar. Konsekuencat e kësaj ishin që në vitin 1981 në Maqedoni kishte rreth 8,000 nxënës që ishin pjesë e klasave në shkollat e mesme shqiptare, por sipas raportimit në gazetën e Sarajevës Oslobodjenje në 6 Janar 1989 ky numër kishte rënie deri rreth 4,000 nxënës. Rënia e numrit të nxënësve shqiptarë ishte për shkak se disa nga nxënësit nuk dinin të flisnin maqedonisht dhe kjo bëri të pamundur që të vazhdonin shkollën në klasat e përziera. Për këtë arsye disa nga mësuesit protestuan ndaj këtij ligji që nuk ishte në favor të shqiptarëve ku në Kumanovë 9 mësues dhe 26 nxënës u përjashtuan. Situata ndryshoi kur në vitin 1988 filluan demonstratat e shqiptarëve në Kumanovë dhe Gostivar, duke bërë titur me sllogane kundër ligjit dhe duke theksuar që të drejtat e tyre duhet të vihen në pah siç është e garantuar në Kushtetutën e vitit 1974.

Sipas Poulton (1995) “në Kumanovë rreth 128 shqiptarë ishin të arrestuar ku organizatorët e protestës ishin të arrestuar gjithashtu, 20 nga ato më pas ishin edhe të burgosur. Për shembull, në gjykatën e qarkut të Shkupit në Janar, tre djem të moshës 32, 29 dhe 19 ishin të dënuar me 6 deri në 11 vjet burg dhe dy djem e dy vajza të tjera rreth moshës 16 dhe 17, ku të gjithë nxënësit në shkollën Panche Popovski në Gostivar, morën dënimin rreth 6 vjet për pjesëmarrjen e tyre në demonstratën e Gostivarit” (f.130).

2.2 Përhapja e stereotipeve më të thella mes maqedonasve dhe shqiptarëve

Maqedonasit kanë atë tendencë për t'i parë shqiptarët si të rrezikshëm për shkak se ato janë myslimanë dhe feja Islame sipas maqedonasve është e rrezikshme sepse sjell një frymë turke në shtetin e tyre. Në fakt, është e vertetë që Maqedonia kohëve të fundit e ka paraqitur si një problem të vështirë tendencën islamike, duke u bazuar në ngjarjet e fundit të

Maqedonisë së Veriut dhe në veçanti nga myslimanët shqiptarë. Për më tepër, përdorimi i stereotipit nga ana e maqedonasve është i bazuar në mungesën e socializimit apo ndërveprimit veçanërisht me një shqiptar. Ndërsa përdorimi i stereotipit *Shka* nga shqiptarët presupozohet të jetë një shkëmbim abuziv shoqëror me një person të përkatësisë maqedonase.

Lind pyetja: Pse ndryshojnë stereotipet *Shka* dhe *Siptar* në bazë të përdorimit të tyre dhe cilat janë ato kultura specifike që krijojnë gjenezën e këtyre stereotipeve. Në Maqedoninë e Veriut, maqedonasit mundohen të caktojnë limite apo të vendosin disa kufij për etnitetet tjera që jetojnë në këtë shtet, veçanërisht për shqiptarët. Këto kufij mund të krijojnë stereotipe më të rrezikshme dhe shkatërruese duke ndaluar krijimin e një marrëdhënieje të mirëfilltë mes këtyre etniteteve që jetojnë në Maqedoninë e Veriut ku për fat të keq, për vite me rradhë paqja ka munguar. Për shkak të këtyre stereotipeve paqja në vend ka munguar, nuk ka pasur qetësi në Maqedoninë e Veriut, ka pasur gjithmonë luftë, turbullira, gjendje me zënka e me grindje.

Pavarësisht se etnitetet e ndryshme jetojnë me njëri-tjetrin në një ambient të ngushtë, ecin rrugëve të njëjta, takohen në shkollë tek spitali apo tek dyqanet, ato përsëri nuk shkëmbejnë asgjë mes veti. Kjo do të thotë se ne jemi aq afër me njëri-tjetrin por në të njëjtën kohë shumë larg. Në ambiente pune apo kolektive është shumë e vështirë të shohish që shqiptarët dhe maqedonasit nuk shkojnë mirë sepse te dyja palët kujdesen për profilin e tyre publik dhe mundohen që të mos kenë ndikim apo impakt negativ në ambient pune dhe për këtë arsye është shumë e vështirë t'i shohish duke patur konflikt në ato rrethana. Edhe pse mundohet që të ruhet paqja në punë dhe marrëdhëniet e mira mes palëve përsëri të gjithë këto palë duke përfshirë edhe etnitetet tjera e dinë shumë mirë që pala tjetër i paragjykon siç ato i paragjykojnë të tjerët. Maqedonasit kanë një tendencë për ta bindur veten dhe të tjerët se shqiptarët do të jenë pjesë e kulturës së tyre vetëm nëse ata vendosin t'i bashkëngjiten kulturës së mirëfilltë maqedonase. Sigurisht kjo mund të ndodh sipas tyre vetëm nëse shqiptarët shpenzojnë një kohë të gjatë me ata dhe vetëm nëse ata shkollohen dhe bëhen “modern” si maqedonasit vetë. Sipas maqedonasve “modern”⁷ janë ato njerëz që jetojnë në

⁷ Modern rrjedhë edhe nga greqishtja që do të thotë: të jetosh në të tashmen ose lidhje me një sërë praktikash shoqërore nëpërmjet të cilave ata e negociojnë marrëdhënien midis të tashmes, të kaluarës dhe të së ardhmes

të tashmen dhe jo në të kaluarën, që ndjekin modën e fundit, që veshin parfumin më të mirë dhe blejnë gjëra të shtrenjta. Kështu e shohin përfshirjen e dy palëve në jetë sociale. Shpesh herë vërehet se nëse një shqiptar shpenzon shumë kohë me palën tjetër ose anasjelltas duke shpërndarë eksperiencat e tyre, me shumë mundësi ato do të afrohen me njëri-tjetrin. Gjithsesi në anën tjetër shqiptarët thonë se nëse maqedonasit nuk dinë të bëjnë ndarjen (sepse nuk duan ta bëjnë) mes *shqiptar* dhe *siptar* atëherë nuk do të ketë asnjë lloj komunikimi në paqe.

Stereotipi që është krijuar për shqiptarët *Siptari* siç është përmendur edhe më lart nuk vjen si pasojë e shqiptarëve që jetojnë në vendet tjera të botës por vetëm për shqiptarët që jetojnë edhe sot në Maqedoninë e Veriut. Ndryshe këto shqiptarë quhen edhe *ardhacakë*, kjo është një formë për të treguar që shqiptarët e ardhur në Maqedoninë e Veriut nuk janë të mirëpritur, nuk janë si shqiptarët e tjerë që jetojnë në vendet e tyre por janë shqiptarë që vjedhin, që merren me trafikimin e drogës, me prostitucion, janë mafiozë, mund të jenë edhe vrasës. Të gjithë këto stereotipe përkufizohen me fjalën *ardhacakë*. Në Maqedoni ka edhe komunitete të tjera p.sh turqit (3.9%) dhe romët (2.7%) apo sërbët (1.7%). Maqedonasit nuk i konsiderojnë ata si komunitete që e kërcënojnë ekonominë Maqedonisë së Veriut, por pasi që shqiptarët përbëjnë më shumë se 20% të popullsisë, atëherë maqedonasit këtë komunitet e shohin jo vetëm kërcënues për ekonominë e vendit por edhe për kulturën e tyre.

Ndërsa shqiptarët në anën tjetër thonë që një përqindje e madhe e shqiptarëve që kanë jetuar në Maqedoni tani më janë në mërgatë dhe janë po ata shqiptarë në mërgatë që e mbajnë Maqedoninë me ekonomi më të fortë sepse shumë prej tyre vijnë në vendlindje dhe investojnë po në të njëjtin vend.

2.3 Pse shqiptarët ndihen të diskriminuar

Sipas Abrahams (1996), "Shqiptarët e Maqedonisë gëzonin një status më të lartë dhe të drejta më të gjera gjuhësore në vitet 1974-89 sesa ato që kishin pas miratimit të amendamenteve kushtetuese nga Shkupi në vitin 1989" (f. 285). Mbi të gjitha, shqiptarët e Maqedonisë në atë periudhë kohore kanë pasur qasje në Universitetin e Prishtinës, sigurisht ku shqipja kishte qenë gjuhë e mësimit për studentët e asaj kohe, por që nga shpallja e

pavarësisë së Maqedonisë, asnjë institucion i arsimit të lartë nuk kishte si gjuhë zyrtare gjuhën shqipe. “Pakënaqësia e krijuar nga këto konsiderata u përforcua nga nënpërfaqësimi i shqiptarëve në trupat e zyrës së ushtrisë, në polici dhe në mesin e stafit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndër institucione të tjera.” (Abrahams, 1996).

Sipas Abrahams studentët shqiptarë janë gjithashtu të nënpërfaqësuar në mesin e nxënësve të shkollave të mesme dhe të universiteteve. “Në mënyrë të veçantë, regjistrimi i vitit 1994 raportoi se shqiptarët përbënin 22.9% të popullsisë së republikës, që nga viti 1995 vetëm 12.4% e shkollave të mesme dhe vetëm 6.5 për qind e studentëve të universiteteve ishin shqiptarë” (Abrahams, 1996). Edhe sot shqiptarët ankohen se baza e stereotipeve dhe paragjytimeve ndaj tyre prej maqedonasve ka qenë problemi i shkollave të pamjaftueshme fillore dhe ato të mesme. “Për qeverinë maqedonase, ekzistenca e një gjuhe shqipe në universitet ishte një çështje e polemikave të larta pasi e perceptonte atë të çonte në ndarjen e vendit në sfera socio-ekonomike paralele.” (Klaudjo, 2017, f. 483) Pavarësisht se shkollat shqiptare u hapën më vonë, shqiptarët ankohen sepse kualiteti i shkollave shqipe ka qenë më i ulët kur krahasohet me shkollat e maqedonasve.

Sipas Poulton (1995) shqiptarët ishin të njohur si nacionalitet jugosllav por jo si një komb. Shqiptarët, shtëpinë kombëtare e kishin jashtë Jugosllavisë dhe për këtë kishin të drejta kulturore dhe edukative. “Nga 1951 në Maqedoni ishin më shumë se 200 shkolla shqiptare, 600 mësues të punësuar me më shumë se 26.000 nxënës, në 1972 ishte zgjeruar në 248 shkolla me 2,150 mësues të punësuar dhe me mbi 60.000 nxënës” (Poulton, 1995, f. 125). Në 9 Korrik 1981 Tanjug, agjencia e lajmeve zyrtare, raportoi se “Atje ishin 287 shkolla fillore shqiptare me 3,000 mësues të punësuar dhe me mbi 74,000 nxënës në atë kohë në Republikën Socialiste të Maqedonisë, për më tepër 8.200 shkolla të mesme morën pjesë në gjuhën shqipe”.⁸ Por, sipas Abrahams, që mendon se shkollat janë hapur vonë për shqiptarët e Maqedonisë dhe për më tepër nuk kanë qenë vetëm problemet e shkollave të shqiptarëve që janë hapur me vonë, por ka pasur edhe probleme të ngjashme apo të thella siç kanë qenë problemet e abuzimeve nga zyrtarët, si dhe pretendimet se media shtetërore ofroi mbulim të pandërprerë gjatë zgjedhjeve parlamentare në 1991 dhe 1994. Kur kjo çështje u dëgjua edhe nga Bashkësia ndërkombëtare u hap diskutimi se stabiliteti në Maqedoni ishte

⁸ Sipas Oslobodjenje, Sarajevë, 6 Janar 1989

në rrezik dhe prandaj morën një numër të masave të dizajnuara për të drejtuar katastrofën. Por sipas Abrahams, bashkësia ndërkombëtare gjithashtu minimizoi shkeljet e të drejtave të njeriut në Maqedoni dhe mbylli kritikën e saj ndaj qeverisë maqedonase.

Duke komentuar gatishmërinë e dukshme të OSBE-së për të heshtur shkeljet e të drejtave të njeriut në Maqedoni, Abrahams (1996) shkruan: "Sigurisht, stabiliteti afatgjatë është një qëllim fisnik. Sidoqoftë, shkeljet e të drejtave të njeriut nuk duhet të tolerohen për ta arritur atë. Një paqe e qëndrueshme mund të zërë rrënjë kur ekziston institucionalizimi i normave demokratike që garantojnë respektimin e plotë të të drejtave të njeriut" (f. 104)

Hulumtimi i Abrahams la një ndikim të madh në shtrimin e politikës maqedonase. Disa vite më vonë pas botimit të librit 'A Threat to Stability: Human Rights Violations in Macedonia' të Abrahams për shkeljen e të drejtave të njeriut, Maqedonia u pranua në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB) sepse kishte një lloj progresi mes maqedonasve dhe grekëve dhe gjithashtu u bënë përparime në aspektin e përfaqësimit shqiptar në nivel administrativ. Pak më vonë kishte edhe lëvizje për bërjen e një universiteti të ri në Tetovë, që njihet zyrtarisht si Universiteti i Evropës Juglindore të Tetovës, ky universitet edhe sot është tre gjuhësor, studentët kanë mundësi për përzgjedhjen e gjuhës në anglisht, shqip ose maqedonisht.

Përveç impaktit me librin e tij që Abrahams la, Arbën Xhaferri është një figurë tjetër politike në Maqedoni që ndikoi tek ndryshimet e marrëdhënieve politike të Maqedonisë. Arbën Xhaferri e kishte atë ide që shqiptarët dhe maqedonasit në kryengritjen e Krushevës në vitin 1903 ishin më të bashkuar, ku jo vetëm këto (shqiptarët/maqedonasit) jetonin në harmoni me njëri-tjetrin por edhe etnitë tjera kishin respekt të ndërsjelltë mes veti. Më vonë z.Xhaferri ishte i dëshpëruar me kushtetutën e Maqedonisë, ku u premtonte shqiptarëve gjithçka si arsimin e lartë, përdorimin e simboleve shqiptare, përdorimin e gjuhës së tyre dhe të drejtën për të themeluar institucionet e tyre, duke përfshirë radio stacionet, teatrot dhe gazetën. Xhaferri shton, megjithatë, se disa nga këto të drejta ekzistonin vetëm në teori. Duke marrë parasysh kritikën e Xhaferit dhe qytetarëve të tjerë, komunistët maqedonas filluan t'i bënin bashkë ose t'i përziejnë nxënësit shqiptarë me ato maqedonas, në këtë mënyrë do të ketë klasa etnike të përziera, duke i kthyer shkollat shqiptare në ato të përziera. Sipas shqiptarëve, maqedonasit e përdorën këtë veprim të kryer për të justifikuar zëvendësimin e gjuhës shqipe si gjuhë mësimore me maqedonishten.

“Pas kësaj, dhe në veçanti pas shpalljes së pavarësisë, sfida më e egër dhe më e trishtuar për Maqedoninë, nuk ishte konflikti me Greqinë, as çështja e integritetit territorial të republikës, por "papajtueshmëria e konceptit etnocentrik e shtetit me realitetin multietnik të vendit” (Xhafer, 2001, f. 42). Por, një autor tjetër Wolf Oschlies në librin e tij Makedonien 2001–2004: *“Kriegstagebuch aus einem friedlichen Land”* kundërshtonte tezën e Arbën Xhaferit ku thotë: *“Marrëdhënia midis maqedonasve dhe shqiptarëve në Maqedoni nuk ishin kurrë të mira, por as kurrë të këqija sa ata të vitit 2001”* (Oschlies, 2004, f. 61)

Një stereotip tjetër i krijuar nga maqedonasit dhe shqiptarët është se maqedonasit gjithmonë kanë qenë me atë mendësi se *“shqiptarët nuk donin të integroheshin në shoqërinë maqedonase, se ata ishin të pabesë ndaj shtetit dhe synonin të bashkoheshin me shqiptarët e Shqipërisë dhe Kosovës”* (Brunnbauer, 2004). Por, në anën tjetër, shqiptarët vazhdimisht tregojnë që konflikti ka filluar për shkak të diskriminimit kundër pakicës shqiptare. Ata i mbështetën pretendimet e tyre jo vetëm nga diskriminimet kundrejt tyre por edhe nga stereotipet e tyre që maqedonasit kanë vetëm iluzione për shqiptarët dhe ata vetë nuk janë të gatshëm të bashketojnë me shqiptarët. Kështu duke u marrë me gjërat e vogla, Maqedonia e Veriut për një kohë të gjatë nuk ka pasur asnjë lloj stabiliteti dhe vazhdon të jetë e dobët, gjë që bëri që maqedonasit etnikë të mos reagonin ndaj kërkesave të pakicës shqiptare. Por, në anën tjetër pakica shqiptare ka zhvilluar një ndjenjë të fortë të identitetit etnik në Maqedoninë e Veriut.

2.4 Përkufizimi i termit ‘Siptari’

Siptar (mashkullorë), *Siptarka* (femërore), *Siptari* (shumës). Këto epitete janë krijuar nga maqedonasit për shqiptarët që jetojnë si një kolektiv etnik. Kjo gjuhë urrejtjeje ka shkaktuar një lloj antipatie nga ana tjetër e shqiptarëve. Sigurisht, ky term *Siptari* i referohet vetëm shqiptarëve që jetojnë në Maqedoninë e Veriut dhe jo atyre që janë jashtë Maqedonisë së Veriut, mbi të gjitha atyre shqiptarëve që sipas maqedonasve janë të ardhur ku ndryshe i quajnë ‘ardhacakë’. Po në anën tjetër *Siptari* i referohet edhe shqiptarëve që *“nuk janë të*

drejtë”, që kërkojnë të drejta “më shumë se sa duhej”. Siç është një thënjë e vjetër popullore maqedonase “ata (shqiptarët) duan të kenë "bukë më të mirë sesa buka që u jepet”.

Pra, *Siptari* do të thotë kur një person ka sjellje të pa hijshme ose sillet në mënyrë jo të drejtë me njerëzit e tjerë. Zakonisht maqedonasit e përdorin këtë kundrejt maqedonasve të tjerë, për tu dhënë atyre një shenjë se ata janë duke u sjellur në mënyrë jo të drejtë dhe ata duhet ta ndryshojnë sjelljen e tyre. Por *Siptari* nuk e ka vetë atë kuptim sipas maqedonasve. *Siptari* janë konsideruar personat jo të ndershëm, të pacivilizuar, të flliqur apo të pistë, budallenj, të frikshëm, të mbyllur, mendjengushtë, mafiozë etj.

Shqiptarët për maqedonasit janë më shumë se kaq, ku sipas tyre shqiptarët i konsiderojnë gratë e tyre si makina për të prodhuar fëmijë dhe për të qenë amvise dhe jo për t’u emancipuar dhe për të shkuar në shkollë. Duke marrë parasysh, shumë prej gjyshërve dhe stergjyshërve shqiptarë janë pa shkollë, sepse ndoshta sistemi ata nuk i ka lejuar për t’u shkolluar. Shpeshherë kemi parë mësues të ardhur nga Shqipëria për t’u dhënë mësim nxënësve shqiptarë të Maqedonisë. Por jo vetëm në Maqedoni edhe në Kosovë, ka pasur mësues të ardhur nga Shqipëria, sepse nuk kanë pasur kuadër të mjaftueshëm. Për këtë arsye shqiptarët sipas maqedonasve janë njerëz të pacivilizuar dhe mendjengushtë. Që në pavarësinë e Maqedonisë në vitin 1991, ndarja mes shqiptarëve dhe maqedonasve filloi të jetë edhe më e dukshme. Ndarja midis "ne" dhe "atyre" ishte thelluar ku nga njëra anë janë shqiptarët dhe nga ana tjetër maqedonasit.

Sipas Neofotistos (2004), në hulumtimin e tij ai tregon që maqedonasit preokupoheshin me përqindjet e larta të shqiptarëve në shtetin e tyre, ku sipas tij maqedonasit thoshin që shqiptarët kjo i bën edhe më agresivë. Maqedonasit kanë një lloj frike kur i shohin shqiptarët të bashkuar, ata gjithashtu i frikësohen rritjes së popullsisë së shqiptarëve, sepse “shqiptarët nuk kërcënojnë kur ata janë vetëm, por kur ata bëhen të bashkuar si grup” (Neofotistos, 2004). Pra shqiptarët në një farë forme kërcënojnë maqedonasit për pjesën territoriale dhe zhvillimin ekonomik, ku gjithashtu janë një pengesë që ky shtet t’i bashkohet Bashkimit Evropian. Në librin “Përtej Stereotipeve: Dhuna dhe depërtueshmëria te kufijtë etnikë në Republikën e Maqedonisë”, Neofotistos shpjegon se maqedonasit në një anë tjetër tentojnë të admirojnë afërsinë, ku të gjithë ndihmohen dhe mbështeten tek njëri-tjetri në kohë nevojë.

Një pjesë tjetër e krijimit të stereotipeve është edhe ideja që maqedonasit u thonë shqiptarëve *Siptari* sepse ata janë njerëz të shëmtuar, ku me krenari thonë që ne i njohim

fytyrat e shqiptarëve nga ato “tonat”. Kur disa studentë nga Universiteti i Galatasaray erdhën të vizitonin Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë dhe Shkup për një hulumtim të tyre që kishte të bënte pikërisht me stereotipet, njëri nga studentët turk pyeti: “Si ka mundësi që ju e njihni njëri-tjetri vetëm nga fytyra?”. Shumë nga kolegët e mi duke e përfshirë edhe veten, nuk ditëm t’i përgjigjemi kësaj pyetjeje. Njëri nga studentët shqiptar tha: “mund të jetë edhe instiktive që ne njohim njëri-tjetrin edhe pa folur, ne e dimë kujt përkatësie etnike i përket dikush”. Maqedonasit që janë të edukuar mund ta bëjnë shumë lehtë dallimin mes asaj ‘q’ dhe ‘i’ e zëvendësuar nga vetë ata. Përndryshe maqedonasit në gjuhën edukative të tyre u referohen si *Albanicite* d.m.th *Shqiptar* e jo *Siptar*.

Pavarsisht se shumë nga ato mund ta bëjnë dallimin ata përsëri kthehen tek urrejtja dhe paragjykimet e mëhershme që kanë pasur. Ata e dinë që shqiptarët me këtë lloj epitete ndihen shumë të provokuar, përsëri sipas tyre është vështirë ta heqin nga përdorimi sepse vetëm në këtë formë u janë referuar shqiptarëve dekada me radhë. Paragjykimet dhe stereotipet kanë një rrënjë të gjatë dhe mos pajtimet e ideve të njëri tjetrit kanë bërë që këto stereotipe të thellohen edhe më shumë. Për shembull, një nga idetë e maqedonasve ka qenë: “pse shqiptarët kërkojnë të drejtat e tyre, kur ata kanë më shumë të drejta se etnitetet tjera që jetojnë në Maqedoni”. Në bazë të kësaj ideje, shqiptarët janë njerëz të thjeshtë që nuk kanë nevojë për të drejtat absolute siç i kanë maqedonasit sepse sipas tyre maqedonasit duhet të jenë në pedestal pavarësisht se jetojnë në një shtet multetnik.

2.5 Përkufizimi i termit ‘Shkie’

Ashtu sic *Siptar* ka konotacion negativ për maqedonasit ndaj shqiptarëve edhe shqiptarët pothuajse kanë një shprehje që e përdorin në mënyrë të ngjashme, *Shkie*. Për shembull, *mos u bë shka*, shqiptarët u referohen shqiptarëve tjerë në mënyrë për tu treguar se sjellja e tyre është e pa hijshme si shumica e sjelljeve të pahijshme të maqedonasve. Një

shprehje tjetër, apo që konsiderohet si e dyta pas *Shkie* është *Guvar*.⁹ ku edhe kjo shprehje përdoret në konotacion negativ prej shqiptarëve ndaj maqedonasve. Kjo është një lloj stereotipi nëse mund ta quajmë kështu sepse shumica e popullsisë maqedonasve jetojnë gjithë jetën duke ju dedikuar fesë asaj krishtere ose ortodokse. Me *Shkie* dhe *Guvar* nënkuptojmë edhe “njerëz jo të besës”, “njerëz të egër”, “egoist”, “të flliqur”, “të prapambetur” etj.

Ndryshe nga maqedonasit që u referoheshin vetëm shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, shqiptarët këto dy shprehje (*Shkie* dhe *Guvar*) i kanë për të gjithë maqedonasit që jetojnë brenda dhe jashtë Maqedonisë së Veriut. Këto shprehje janë krijuar për ta bërë ndarjen midis “ne” dhe “ata”. Sipas Neofotistos (2004) shqiptarët u referohen maqedonasve si “njerëz të prapambetur” sepse ata nuk i respektojnë pjesën tjetër të popullatës që janë shqiptarët dhe presin që shqiptarët të punojnë në shërbimin e tyre. Por jo vetëm shqiptarët, nga kjo mendësi janë prekur edhe komunitetet tjera si turkët dhe romët.

Shqiptarët janë të njohur për Besën, ato krenohen për këtë veti që i karakterizon, por i konsiderojnë maqedonasit të pa besë, ku askush nuk mund të mbështetet tek ato sepse ato mund të tradhëtojnë dhe janë njerëz me dy fytyra. Gjithashtu, shqiptarët krenohen me idenë që janë më të pastër, me të dashur, shumë më shumë të besueshëm dhe mbi të gjitha më empatik kur vjen çështja tek kujdesja e familjes e sidomos të atyre që janë më të moshuar. Sipas shqiptarëve thuhet që maqedonasit nuk kujdesen për prindërit e tyre kur ata kanë nevojë dhe ata i braktisin prindërit e tyre kur ata janë në një moshë të thyer. Gjithashtu, maqedonasit i dërgojnë prindërit e tyre te shtëpia e pleqve vetëm që të rinjtë të kenë hapësirën e tyre dhe të mos pengohen nga të moshuarit. Shqiptarët këtë e shohin si një moskujdesje ndaj prindërit por në fakt në shumë shtete Evropiane e praktikojnë këtë idenë e ndarjes ndaj prindërve në një moshë shumë të re. Ndoshta në këtë rast, nga Evropianët do të krijohet një stereotip për shqiptarët se nuk janë shumë të emancipuar.

2.6 Religjioni si pjesë e stereotipeve të përbashkëta të shqiptarëve dhe maqedonasve

⁹ Një term tjetër që shqiptarët ndonjëherë përdorin për të nënvizuar ndarjen etnike midis "ne" dhe "ata" dhe të regjistrojnë përjashtimin social ndaj anëtarëve të kolektivitetit maqedonas është termi turk "Gavur" (i pafe)

Shqiptarët në Maqedoni përbëjnë më shumë pjesën e shqiptarëve mysliman sesa atyre katolik ose ortodoks. Shqiptarë ortodoks ka në fshatrat e largëta të Ohrit dhe Gostivarit, ka edhe një pjesë të katolikëve shqiptarë që jetojnë në Shkup. Për shkak të kompleksitetit të religjioneve, ky hulumtim ka për qëllim impaktin e religjioneve dhe krijimin i stereotipeve përmes tyre. Shumë nga maqedonasit mendojnë që shqiptarët që e zbatojnë fenë islame janë më të prirur për të qenë nacionalist ndërsa të tjerë që janë zbatues të kësaj feje thonë që shqiptarët nuk kanë ndonjë besim të fortë dhe janë ata klerikë mysliman që mundohen ta ndalojnë urrejtjen mes dy popujve.

Gjithsesi, autoritetet maqedonase në një periudhë të caktuar kohore nuk e kanë ndarë të njëjtin mendim si shqiptarët sepse i kanë parë myslimanët shqiptarë si një mjet që shqiptarët të asimilojnë grupet e vogla myslimane në Maqedoni si turqit, torbeshët dhe romët. Shumë shqiptar i edukonin fëmijët e tyre me preceptime islamike duke përdorur gjuhën arabike dhe jo maqedonishten nëpër klasa. Ky veprim për maqedonasit ishte një kërcënim nga shqiptarët për t'i "manipuluar" fëmijët shqiptarë të mos mësonin gjuhën maqedonase. Më vonë autoritetet maqedonase ndryshuan ligjin në religjionin e mësimdhënies për të ndaluar pjesëmarrjen ose për të ndaluar organizimet e instruksioneve religjioze prej fëmijëve nga mosha 16, për të ndaluar influencën e fesë Islame.

"Ka pasur katër çështje për ata shqiptarë të cilët refuzonin bashkëpunimin: njëra është agjitacion nacionalist; një tjetër është emigrimi; e treta është përparimi ekonomik, veçanërisht i fortë në qytetet e Maqedonisë perëndimore - më së shumti Gostivar, ku ka ndodhur një bum ndërtimi; i katërti është Islami." (Koppa, 2001)

3. MAQEDONIA E VERIUT NË SYTË E VENDEVE PERËNDIMORE

Ky vend i vogël ballkanik është mjaft i lirë nga stereotipet që vijnë nga vendet e Evropës Perëndimore. Maqedonia shpesh shoqërohet si vend i bukur dhe destinacioni ideal i udhëtimit. Grekët dhe bullgarët, përkundrazi, tentojnë të paragjykojnë Maqedoninë, por kjo

është më shumë politike sesa kulturore. Por megjithatë kjo nuk do të thotë ata i kanë ikur të gjitha stereotipeve dhe paragjytimeve nga vendet tjera të botës.

Bullgaria ishte një nga vendet e para që njohu Maqedoninë e pavarur, disa mosmarrëveshje i tensionuan marrëdhëniet e tyre për disa vite. “Kryesisht për shkak të ndjenjave nacionaliste, Bullgaria pohoi se gjuha maqedonase është thjesht një dialekt bullgar. Prandaj, Bullgaria nuk e njohu ekzistencën e një kombi të veçantë maqedonas” (A conflict analysis - Macedonia, 2003)

Mosmarrëveshja midis Greqisë dhe Maqedonisë që shpërtheu në 1991 në thelb ka të bëjë me pronësinë e trashëgimisë kulturore të lashtë Maqedonase. Siç kemi njohuri, për një kohë të gjatë Greqia ka refuzuar emrin e Maqedonisë, duke hedhur dritë mbi paragjykimet se Maqedonasit janë njerëz pa identitet. Sigurisht, ky lloj paragjykimi ka edhe bazën e vete, ku grekët gjithmonë e mbështesin idenë se maqedonasit e lashtë ishin grekë. Nga ky këndvështrim, kombi maqedonas është një "krijim artificial" (i Jugosllavisë së Titos). “Prandaj, në terminologjinë zyrtare greke, Republika e Maqedonisë njihet si ‘Republika e Shkupit’.” (A conflict analysis - Macedonia, 2003, f. 14). Gjithashtu për nacionalistët grek, gjuha maqedonase është një dialekt i bullgarishtes ku grekët ndajnë të njëjtin mendim me bullgarët.

Gjithsesi ajo çka mbetet e qartë është se jo vetëm shtetet ballkanike por edhe vendet e perëndimit kanë stereotipe për Ballkanin për shkak se i përket një cepi të Evropës Lindore si p.sh:

- Ata mendojnë për Bullgarinë si një shtet vasal i prapambetur dhe statik i Bashkimit Sovjetik.
- Ata e shohin Rumaninë si më të pavarur dhe anëtare të Paktit të Varshavës për shkak të politikës së saj të jashtme individualiste.
- Malazetët: Përtacë, njerëz me mustaqe të mëdha që jetojnë në male.
- Boshnjakët: Njerëz jo aq inteligjentë të klasës punëtore. Myslimanët boshnjakë janë të këndshëm dhe mikpritës, por njerëz të thjeshtë dhe jo aq të ndritshëm.
- Sllovenët: njerëz të bukur, të civilizuar, të thjeshtë dhe modestë. Por disa njerëz përdorin për të thënë se ata janë të lirë, frikacakë, por njerëz të mirë të biznesit.
- Kroatët: Ata gjithmonë duan të jenë si sllovenët, por kurrë nuk arrijnë sukses dhe gjithmonë përfundojnë si serbët.

- Serbët: Njerëzit që mendojnë se çdo gjë rreth tyre është e tyre dhe se bota rrotullohet rreth tyre. Ata janë të guximshëm dhe të gatshëm për luftë.
- Shqiptarët e Kosovës janë punëtorë (punojnë në furrë) ose kriminelë.
- Maqedonasit: Njerëz të thjeshtë që e duan muzikën, por gjithmonë vjedhin historinë greke etj.

Një problem tjetër që u shfaqet maqedonasve sidomos kur shkojnë jashtë në qytetet tjera ballkanike por edhe më gjerë është se të tjerët e thirrin këtë shtet si: the former Yugoslav Republic of Macedonia, jo si Republika e Maqedonisë Veriore. Ku kjo është shumë fyese për këtë nacionalitet dhe maqedonasit nuk e pranojnë një gjë të tillë. Dikush thotë që nëse na thirrin FYROM sidomos në Greqi atëherë situata do të shkoj në një drejtim tjetër. Në anën tjetër, ekziston një stereotip pozitiv nga të tjerët që vinë për maqedonasit duke thënë se ata janë edhe shumë të shoqërueshëm dhe dëshirojnë të të ndihmojnë qoftë edhe për një orientim të vogël. Maqedonasit janë dhe mikpritës ata dëshirojnë t'i takojnë miqtë e tyre. U pëlqejnë të gatujnë ushqime tradicionale dhe t' shpërndajnë me të tjerët.

3.1 Reduktimi i paragjyqimeve dhe stereotipeve mes etnive të Maqedonisë Veriore

Karakteri multietnik i shtetit maqedonas gjithashtu përfshin dallimet e statusit dhe mosbesimin reciprok mes komuniteteve. Dispozita kushtetuese për barazi, paraqet bazë juridike për miratimin e Ligjit të ri për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi (LPMD). Ky ligj përmban dispozita me të cilat ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë jo vetëm në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë etnike, gjuhës, nënshtetësisë, religjionit apo bindjes fetare, por edhe në bazë të gjinisë, përkatësisë së ndonjë grupi të marginalizuar, prejardhjes sociale, arsimit, përkatësisë politike, bindjeve tjera, statusit personal, shoqëror, familjar apo martesor, pengesave psikike apo fizike, moshës, statusit pronësor dhe gjendjes shëndetësore, si dhe në çfarëdo baze tjetër e përcaktuar me ligj ose me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare.¹⁰ Mbi të gjitha ky ligj paraqet parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

¹⁰ Definicion të ngjashëm përmban dhe Ligji për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 50/2010, nga 13.04.2010, neni 7. Ligji për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi duhet të zbatohet nga 1 janari i vitit 2011

“Ajo që LPMD-në e bën jashtëzakonisht të rëndësishëm për Republikën e Maqedonisë Veriore është fakti se paraqet ligjin e parë që, në mënyrë të përgjithshme, e ndalon diskriminimin” (Poposka, 2010). Nëpërmjet këtyre ligjeve për diskriminimin, në mënyrë të veçantë, një rëndësi e madhe u jepet edhe diskriminimit të përkatësive etnike.

Ligji për Avokatin e Popullit është shumë i rëndësishëm për mbrojtje nga diskriminimi etnik. Në realitet, me Ligjin e ri për Avokatin e Popullit, kompetencat e Avokatit të Popullit zgjerohen pikërisht në pjesën e mbrojtjes së parimit të mosdiskriminimit, si dhe të parimit të përfaqësimit të drejtë dhe përkatës të pjesëtarëve të bashkësive në organet e pushtetit publik.¹¹ Në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Maqedonisë, mbrojtja gjyqësore lidhur me ndalimin e diskriminimit është në kompetencat e Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut.¹² Si organ gjyqësor i rëndësishëm në lidhje me pjesën e mbrojtjes së diskriminimit është Gjykata për të Drejtat e Njeriut e Këshillit të Evropës, Gjykata Evropiane për Drejtësi e BE-së si dhe organet e tyre ndihmëse.

Avokati i popullit, në fakt ka ekzistuar që në vitin 1997, e sigurisht detyra themelore e tyre është thjesht t’i mbrojnë të drejtat ligjore të qytetarëve në rast se këto të drejta shken nga ana e organeve të ndryshme shtetërore. Pra, përfaqësimi i Avokatit të Popullit është, vënia në pah e të drejtave të bashkësive etnike në kuadër të organeve të pushtetit publik. Pavarësisht kësaj, Avokati i Popullit ka disa mangësi. Për shembull, kompetencat e Avokatit të Popullit nuk përfshijnë sektorin privat dhe fakti që rekomandimet e tij nuk kanë karakter obligues. Gjithsesi këto mangësi priten që të eliminohen.

Programi i OKB-së, i implementuar nga UNICEF, ka punuar për t’i parandaluar stereotipet dhe paragjykimet mes etnive. Pra, programet e tyre mundësojnë që të ketë aktivitete dygjuhësore pas shkolle. Kjo e bën edhe më të lehtë për t’i parandaluar paragjykimet dhe për të pasur mundësi për t’i njohur kulturat tjera. “Punëtoritë e zhvilluara nga Qendra për të Drejtat e Njeriut dhe Zgjidhja e Konfliktëve fillimisht u mbajtën në 12 shkolla fillore dhe të mesme në vitin 2010. Ata ndjekin një metodologji të strukturuar dhe udhëhiqen nga mësuesit të trajnuar” (Janevska). Shkollat ku janë mbajtur këto aktivitete kanë qenë më së shumti në Kërçovë, Strugë dhe Kumanovë, ku rreth 4,000 studentë kanë

¹¹ Ligji për Avokatin e Popullit, Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 60/2003 nga 22.09.2003, neni 2.

¹² Shiko Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese (neni 51 dhe 56).

marrë pjesë në këto trajnime. Nëse vazhdohet kështu me trajnime atëherë për të gjithë do të jetë e lehtë për t'i larguar stereotipet dhe paragjykimet ndaj njëri-tjetrit.

3.2 Maqedonia Veriore midis diversiteteve kulturore dhe paragjykimeve

Hulumtimet e kryera në vitin 1993 përfunduan se paragjykimet e maqedonasve ndaj shqiptarëve dhe romëve ishin bërë të dukshme, sikur paragjykimet e shqiptarëve ndaj maqedonasve dhe romëve. Krahasimi i rezultateve nga hulumtimi i kryer në 1987-1988 Simoska në analizën e saj ku shumë të anketuar, duke përfaqësuar të gjithë etnikët grupet, mendonin se "njëri duhet të jetë besnik vetëm për njerëzit e vet", dhe se "gjithnjë duhet të japim përparësi për njerëzit tonë".

Të dhënat mbi stereotipet dhe paragjykimet e zakonshme nga hetimi i Simoskës në vitin 1996 tregojnë se maqedonasit e shohin veten si punëtorë, paqësorë dhe të ndershëm, ndërsa mendojnë se shqiptarët janë primitivë dhe të prapambetur. Shqiptarët, nga ana tjetër, zakonisht e shohin veten si të zellshëm, të ndershëm dhe të arsimuar, dhe maqedonasit si të pandershëm, por punëtorë. Edhe turqit i konsiderojnë maqedonasit si të zellshëm, por edhe të qetë dhe të kulturuar, dhe ata kanë të njëjtin mendim për veten e tyre. "Paragjykimet e fshehura nga të gjitha këto grupe duket se konvergjojnë kur vlerësohen grupet e tjera: serbët janë agresivë dhe militantë, romët janë të varfër dhe dembelë, dhe vllahët janë të dhembshëm dhe të zgjuar" (A conflict analysis - Macedonia, 2003, f. 28)

3.3 Aspektet deklarative kundrejt pamjes reale

Pas rënies së socializmit, një konflikt shpërtheu midis Forcave të Armatosura të Maqedonisë dhe Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK). Duke e marrë parasysh se shqiptarët e Maqedonisë përbëjnë 25 përqind të popullatës, kjo etni kërkon më shumë të drejta. Në anën tjetër pala maqedonase thotë që ata kanë të drejta të mjaftueshme në Maqedoni dhe nuk kanë nevojë të kërkojnë më shumë. Për më tepër, konflikti i shqiptarëve dhe maqedonasve është ende i freskët edhe pse ato mundohen të negociojnë me stereotipet që kanë mes veti në rutinën e tyre të përditshme. Sot fqinjët e Ballkanit e konsiderojnë Ballkanin

si të prapambetur, sipas Nefotistos (2008) konflikti i vitit 2001 e bëri "Ballkanin" me etnitet gjeopolitik konkret që ishin të vendosur në ish-Jugosllavi dhe që ishin shumë të prapambetur.

(Nefotistos, 2008) "Çairi është më shumë i populluar me shqiptarë që kanë jetuar në Shkup para Luftës së Dytë Botërore (ndryshe të quajtur si banorë të vjetër) gjithashtu shqiptarë që kanë ardhur në Shkup nga fshatrat e Maqedonisë dhe Kosovës pas vdekjes së Titos në vitin 1980 duke shpërbërë Jugosllavinë (të ashtuquajturit "ardhacakë"). Por, përveç shqiptarëve, në Çair jetojnë edhe maqedonasit, turqit, romët, boshnjakët, serbët dhe vlllehët gjithashtu". (f. 19)

Ish kryeministri i Republikës së Maqedonisë Vlado Buçkovski ishte në një konferencë në vitin 2005 në Fondacionin e Trashëgimisë në Uashington DC në një vizitë zyrtare në Amerikë. Sipas Nefotistos (2008), Buçkovski tregonte që Maqedonia ka pasur një lloj progresi të madh që nga Marrëveshja e Ohrit në vitin 2001, me stabilitetet multietnik dhe demokratik. Mbi të gjitha ai shpalli Maqedoninë si "demokracia e vetme funksionale dhe stabile multietnike në Ballkan". Ku sipas tij ky është një sukses ku shihet si një shembull për pjesën tjetër të Ballkanit.

Kritikat e NATO dhe Bashkimit Evropian sipas Buçkovskit e kanë bërë edhe më të fortë Maqedoninë si shtet drejt një demokracie të mirëfilltë dhe se Maqedonia do jetë gjithmonë e gatshme për të mbështetur parimet demokratike. Për më tepër ai theksoi se përmes bashkëpunimit ndëretnik, Maqedonia është larguar nga të qenurit një "konsumator" për të qenë një "prodhues" i sigurisë dhe stabilitetit. Në fund të fjalimit të tij, ai theksoi se duhet të marrin parysh suksesin e Maqedonisë ku Amerika dhe Evropa mund të bëjnë shumëçka për ta suportuar demokracinë. Gjithashtu, Maqedonia e Veriut tashmë është shtet multietnik që është gati për tu integruar në strukturat euroatlantike. Për më tepër Nefotistos (2008), mendon që ky mesazh i ish Kryeministrit të atëhershëm Vlado Buçkovski paraqet një mesazh të qartë që Maqedonia ka punuar me Perëndimin dhe është në interesin e tyre për tu bashkuar me NATO dhe Bashkimin Evropian ku marrëdhëniet multietnike janë përmirësuar dhe gjithashtu është në interesin më të mirë të Perëndimit që të na mbështesë në përpjekje të tilla si një mënyrë për ta futur demokracinë në Ballkan dhe duke motivuar vendet e tjera të Ballkanit që të mbështesin transformimet e mëtejshme demokratike.

Në fjalimin e tij nuk u përmend në asnjë moment që shqiptarët dhe maqedonasit ende jetojnë me stereotipet dhe paragjykimet e njëri-tjetrit dhe stabiliteti multi-etnik nuk është ashtu siç ka deklaruar ish Kryeministri Vlado Buçkovski, as para një dekade të fjalimit të tij as

sot. Mbi të gjitha nuk u përmendën as grupet e vogla që edhe sot luftojnë për të dretat e tyre bazike. Jo më vonë në zgjedhjet e fundit lokale, ish-ministrja e brendshme e Maqedonisë, Gordana Jankulovska përmes përgjiimeve bën plane si t'i ndalojë shqiptarët të mos vijnë nga mërgata që të mos votojnë kryetarin shqiptar në komunën e Kërçovës. Përveç kësaj, ajo shprehet edhe me fjalë tjera të urrejtjes kundrejt shqiptarëve si "Nëse ne duhet të tregojmë se kush është më i fortë, ne mund t'i shkatërrojmë brenda një ore", ¹³ tha Jankulovska, duke iu referuar shqiptarëve.

Gjithsesi duke e marrë parasysh që krerët e lartë të Maqedonisë së Veriut e thonë me krenari se jemi shtet multi-etnik stabil dhe të tjerët duhet të na marrin si shembull suksesi ashtu siç ka pohuar Ish-kryeministri i Maqedonisë Vlado Buçkovski në takimin e tij zyrtar në shtëpinë e bardhë në vitin 2005. Tendanca për të pasur marrëdhënie të mira me njëri-tjetrin është e domosdoshme por e porealizueshme deri më sot. Deklaratat e qeveritarëve të lartë kundrejt pamjes reale tregojnë se Maqedonia e Veriut ka ende shumë punë për të bërë.

3.4 Komunitetet e Maqedonisë së Veriut që bashkëjetojnë veç e veç

Pothuajse për një kohë të gjatë deri më sot komunitetet e Maqedonisë së Veriut kanë jetuar të ndarë pavarësisht se kanë jetuar në një lagje me njëri-tjetrin. Realiteti i situatës së Maqedonisë së Veriut është që në këtë shtet etnitetet e ndryshme nuk përziën ose ka shumë pak raste të tilla kur shohim që një shqiptar krijon një familje me një turk ose aq më pak me një maqedonas. Për fat të keq kjo situatë si duket nuk ka për të ndryshuar për një kohë shumë të gjatë. Një studim i bërë nga sociologu Josifovski (1974), në një fshat në Pollog (që përfshin

Mixed Macedonian–Albanian marriages, 1952–99

Year	1952	1968	1974	1980	1991	1994	1999
Number of mixed marriages	27	18	51	43	31	28	16
Percentage of all marriages	0.21	0.13	0.34	0.27	0.20	0.18	0.11

¹³ Artikulli nga Top-Channel për Ish-ministren e Maqedonisë Gordana Jankulovska: <http://top-channel.tv/english/macedonia-surveillance-audio-show-anti-albanian-sentiment-of-vmro-officials/>

zonën e Gostivarit dhe Tetovës) tregon se 95% të kryefamiljarëve të shqiptarëve dhe maqedonasve gjithashtu 85% të turqve nuk do të lejonin që djemtë e tyre të martohen me një vajzë të etnitetit tjetër, brenda etnive që jetojnë në Maqedoninë e Veriut. Ndërsa për vajzat të marrin për bashkëshort nga një etni tjetër kundërshtohet edhe më shumë. Martesat e përziera në Maqedoni janë shumë të vështirë për t'i gjetur. Një studim i bërë nga Brunnbauer (2004) në librin: "Fertility, families and ethnic conflict: Macedonians and Albanians in the Republic of Macedonia, 1944–2002" tregon se sa ka qenë përqindja e martesave të maqedonasve me shqiptarët rreth vitit 1952-1999.¹⁴ Më poshtë e gjeni tabelën.

Që kur Republika e Maqedonisë u bë e pavarur në vitin 1991, tensionet midis popullatës maqedonase me shumicë dërrmuese ortodokse dhe pakicës shqiptare, janë ndërlikuar edhe më tepër. Banuesit e Maqedonisë që janë shqiptarë janë rritur në numër këto 50 vitet të fundit dhe pjesa e maqedonasve është në rënie gjatë këtyre pesë dekadave të fundit. Rritja e popullsisë shqiptare shkakton stres mes maqedonasve që frikësohen të bëhen pakicë në vendin e tyre. Shumë maqedonas pohojnë gjithashtu se një numër i madh shqiptarësh nga Kosova dhe Shqipëria kanë ardhur në Maqedoni. Frika demografike është intensifikuar me modelin e përqendruar të vendbanimit të pakicës shqiptare. Shqiptarët përbëjnë shumicën e popullsisë në një rajon bashkimi në pjesën veriperëndimore dhe perëndimore të vendit, duke mbuluar rreth një të gjashtën e territorit të vendit. Maqedonasit zakonisht iu referuan traditës gjoja të gjatë të nacionalizmit shqiptar në vend dhe i akuzuan ekstremistët shqiptarë nga Kosova që planifikonin të zinin zonat shqiptare të Maqedonisë dhe mbi të gjitha i fajësonin ato vajza të cilat vinin vetëm për tu martuar me maqedonasit dhe të krijonin familje me etnin maqedonas. Stereotipi se shqiptarët janë sundues ka lindur edhe kur filloi lufta e Kosovës me Serbinë në vitin 1998. "Ata gjithashtu theksuan se pakica shqiptare në Maqedoni gëzonte të drejta ekstensive të pakicave, më shumë se çdo minoritet tjetër në çdo vend të rajonit" (Frckoski, 1998, fv. 24-25).


4. ANALIZA E ANKETËS

¹⁴ Burimi i marrë nga: Republicki zavod za statistika, *Statistički godišnik 1954*, f. 88

Kur Republika e Maqedonisë u themelua në vitin 1944, popullsia e saj përbëhej nga dy grupe të mëdha të ndara me një dallim të qartë fetar: sllavët e krishterë e ortodoksë dhe shqiptarët e turqit myslimanë. Në atë periudhë kohore, shumica e turqve u larguan nga Maqedonia dhe kështu shqiptarët mbetën si pakica më e madhe. Që atëherë deri më sot ata tregojnë pakënaqësi se nuk gëzojnë të drejta të barabarta. “Në vetë-perceptimin e Republikës së Maqedonisë, shqiptarët pothuajse nuk ekzistonin si një pjesë përbërëse e popullsisë së vendit (Brunnbauer, 2004, f. 587)”. Për këtë arsye analiza e anketës fokusohet tek maqedonasit, shqiptarët por edhe marrëdhënia e maqedonasve me romët e turqit përmes prizmit të stereotipeve dhe paragjyqimeve e diskriminimeve.

Gender


203 responses



Rreth 200 persona janë përgjigjur anketës që unë kisha përgatitur për këtë hulumtim, ku mosha me përqindje më të madhe në participim ishte 25 deri në 30.

Age


203 responses



Siç shihet më poshtë në tabelë janë 51.2% shqiptarë që kanë marrë pjesë në anketë, 28.1% maqedonas, 9.9% janë të etnisë turk dhe 10.3% janë romë. Andrew Rossos (2008) thotë

Ethnicity

203 responses



që shqiptarët dhe turqit ishin nacionalist sepse “shtëpia” e tyre nacionale ishte jashtë Jugosllavisë. Shprehja e Rossos e bën edhe më të thjeshtë për t’i kuptuar stereotipet edhe paragjykimet që këto etni kanë për njëri-tjetrin. Por, lind pyetja pse romët ndihen të diskriminuar në Maqedoninë Veriore sepse arsyeja e shqiptarëve dhe turqëve siç përmend Rossos nuk mund të jetë. Për të parë më shumë rreth analizës së marrëdhënieve të këtyre etnive mbetet të shihet në vazhdim të hulumtimit.


4.1 Ndikimi i mediave në forcimin e stereotipeve dhe paragjykimeve

Stereotipet dhe paragjykimet në Maqedoninë e Veriut mund të variojnë nëpërmjet qëndrimeve që ne kemi krijuar, nga media, shoqëria dhe informata tjera indirekte. Media luan një rol të rëndësishëm në përpilimin dhe rritjen e paragjykimeve, stereotipeve ose urrejtjes. Ndonjëherë kjo ndodh pa vetëdije, ndërsa ka dhe raste të tjera kur janë të qëllimshme. Zakonisht shqiptarët shohin televizione shqiptare, maqedonasit ato maqedone dhe turqit ose romët njërin nga këto dy televizione. Kjo e bën edhe më të vështirë për t’i dalluar stereotipet sepse thellë në vete ne mendojmë se ata janë të vërteta dhe nuk janë stereotipe. Kur ndodh që informacionet apo zëra të izoluar të paraqesin fakte që përgënjeshtrojnë një stereotip, media nuk kujdeset që ta korrigjojë këtë stereotip, po më së shumti e paraqet rastin.

Një nga pyetjet e anketës ishte: “A kontribuon media ne përforcimin e stereotipeve etnike dhe paragjytimeve?”. Siç e shihni në tabelën më poshtë përqindja më e madhe e të anketuarit mendojnë që media është një faktor kryesor për ndikimin e stereotipeve negative mes shoqërive etnike. Kjo tregon se shtetasit maqedonas janë të vetëdijshëm për impaktin e mediave dhe kjo bën që të jemi më të kujdesshëm sepse ajo që lexojmë dhe shohim nëpër radio, gazeta, televizione jo gjithmonë është e vërtetë.

Does media contribute to strengthening stereotypes and ethnic prejudices?

199 responses



Kur ndodh që informacione apo zëra të izoluar të paraqesin fakte që përgënjeshtrojnë një stereotip, media nuk kujdeset që ta korrigjojë këtë stereotip, por më së shumti e paraqet rastin. Në këto situata, në media shfaqen fraza banale të tilla, si për shembull, “ka edhe shqiptarë e turq të mirë”, apo “nuk është e tillë e gjithë shoqëria maqedonase”, të cilat në vend të korrigjojnë stereotipin, e përforcojnë më shumë atë. “Në mediat shqiptare gjenden jo rrallë raste të thirrjes në ndihmë të stereotipeve për të shpjeguar një situatë, në mënyrë që perceptuesi të marrë atë sens që ka edhe dhënësi i mesazhit që është njëherësh edhe bartës i stereotipit. Kështu në një koment të kohëve të fundit, qëndrime ekstremiste stigmatizuese të një individi shpjegohen me origjinën e tij etnie. Autori i komitetit përpiqet të provojë se personi i fokusuar, i urren disa kategori të shoqërisë, për shkak se ka X origjinë etnike” (Zguri, 2015).

Që do të thotë më tej, se të gjithë personat që i përkasin kësaj etnie, kanë të njëjtën urrejtje si edhe personi në fjalë. Siç shihet në këtë rast kemi të bëjmë me “një antipati të bazuar në një përgjithësim të gabuar” dhe me sindromën e përdorimit të rasteve individuale për të bërë portretizim kolektiv, portretizim i cili në raste të ngjashme rezulton në përgjithësimet vulgare si “grekët janë të ligj”, “çamët janë të pabesë”, “gjirokastritët janë

koprracë”, etj. Krahas nacionalizmit konfliktual, studiuesit flasin edhe për “nacionalizmin banal”, që nënkupton më së shumti nacionalizmin që zhvillohet në mënyrë të heshtur në përditshmërinë e një shoqërie, kur ajo është në faza normale zhvillimi. Në këtë fazë siç thotë Michael Billing, “ideja e përkatësisë kombëtare shpaloset rregullisht në praktikat rutinë dhe në diskutet e përditshme, veçanërisht në ato të medias, ... Përmes shpalosjeve të tilla, kombet e stabilizuara riprodhohen si kombe dhe popullsitë e tyre kujtohen në mënyrë të pazëshme për identitetin e tyre kombëtar. Kjo shpalosje banale ofron bazën e ngrehinës që e kthen dheun në atdhe.” Gjithmonë e kemi parasysh se mediat janë një fuqi që në bazë të modelit të Biotop-it tregon se mediat zakonisht bashkëpunojnë me partitë politike ku mbështesin njëra-tjetrën. Problemi qëndron se media imponon të rinj e të mëdhenj, të vegjël e të moshuar se çfarë ne duhet të mendojmë për shtetet tjera. Si janë realisht ata, janë hajdut, vjedhës apo mafioz. Integrimi ballkanik në shtetet multi-etnike ballkanike nuk ka qenë i lehtë. Sa herë që do të shkojmë në këto shtete, është shumë e vështirë që mos hasësh në persona që nuk janë nacionalistë.

Pra media luan një rol të rëndësishëm duke i përforcuar ose vendosur në qendër stereotipet paragjyquese, në mënyrë të vetëdijshme ose jo, sidomos në temat që lidhen me përkatësinë fetare, homoseksualitetin, statusin shoqëror dhe sidomos stereotipat apo paragjykimet etnike. Dikush mund të thotë se media është vetëm për të informuar, por ka edhe nga ato bindje që thonë se media duhet të mësojë t’i japi kahje më të mirëfilltë gjërave që na prekin çdo ditë siç mund të jenë stereotipet dhe paragjykimet. Gazetarët, në asnjë mënyrë nuk guxojnë të shprehen me gjuhë urrejtjeje sepse duhet të mbajnë qëndrimin e tyre ashtu siç tregojnë rregullat kryesore të gazetarisë “A transmetohet vërtet një informacion neutral p.sh. për pakicat kombëtare apo ato trajtohen sipas një klisheje të caktuar, e cila shfaq një pamje jo aq të favorshme të tij? Si pasqyrohen në media dallimet në bazë të statusit shoqëror? Si pasqyrohen dallimet mes bindjeve të ndryshme fetare? Këto dhe të tjera janë pyetje që secili duhet t’i bënte në kuadër të një edukimi mediatic kritik. Paragjykimet siç thonë edhe studimet janë të lidhura ngushtë me jetën e njerëzve dhe është e vështirë të zhduken, përse kohë ato janë konstruksione të ngritura qysh në fëmijëri. Sidoqoftë, aspekte të tilla si racizmi apo diskriminimi mund të eliminohen meqë ato krijohen gati tërësisht nga ndikimi i masmedias dhe realitetit që ajo përçon”. (Musai, 2011, f. 22)

Në anën tjetër kemi edhe media të cilat punojnë për të promovuar diversitetin kulturor në Maqedoninë e Veriut. Por, kemi edhe media që edhe sot e kësaj dite punojnë të

ndarë. Kjo ndarje etnike është reflektuar edhe në tregun e medias. Portalet e maqedonasve dhe shqiptarëve punojnë veçmas, është shumë e vështirë të gjejmë një portal që është dygjuhësor. Ndërsa sa i përket televizioneve në Maqedoninë e Veriut, ka vetëm një televizion që është bilingual dhe që shpesh ballafaqohet me kërcënime nga qeveria. “Televizioni Alsat-M është kanali më i besueshëm në Maqedoni, nga shikuesit shqiptarë dhe maqedonas”¹⁵. Ky televizion sigurisht ka një impakt të madh tek audienca shqiptare dhe maqedonase. Ideja e bilingualizmit në këtë televizion për të kontribuar në të dyja anët etnike të problemeve dhe për t’i definuar pikëpamjet e tyre politike, ekonomike dhe kulturore. “Emisionet e lajmeve dhe ato informative të televizionit Alsat-M, që janë edhe shtylla e programacionit, prodhohen në shqip dhe maqedonisht dhe transmetohen në orare të ndryshme; lajmet në shqip lexohen nga folës shqiptarë ndërsa ato në maqedonisht lexohen nga folës maqedonas. Përmbajtja e lajmeve gjithashtu është e njëjta por ato janë të lexuara në gjuhën përkatëse.” (Ndrio, 2015, f. 69).

Kjo tregon se mund të ketë barazi në punë. Gjithashtu për shqiptarët është e lehtë sepse ata janë të gatshëm të mësojnë gjuhën maqedonase nëpërmjet televizionit. Ndërsa maqedonasit shpesh herë e injorojnë dhe nuk duan ta mësojnë. Me këtë nënkuptojmë se shqiptarët janë në gjendje të debatojnë apo gazetarët kanë mundësi të bëjnë intervista në gjuhën maqedonase në nivel të lartë dhe kjo u jep përparësi gazetarëve shqiptarë të jenë pjesë e çdo debati politik që është i rëndësishëm. “Një ndër temat më të nxehta të debatit ngritur nga Alsat-M është ajo e përdorimit të gjuhës shqipe si gjuhë e dytë zyrtare në vend” (Ndrio, 2015, fv. 767-772).

4.2 Multikulturalizmi si proces i rëndësishëm në diversitetin kulturor

“Për t’i mbrojtur gjuhët autoktone dhe për t’i ruajtur ato është pjesë e të drejtave universale të njeriut. Çdo qenie njerëzore ka të drejta për të përdorur gjuhën e tij/saj. Gjuha është baza e identitetit të një personi dhe mjeti i komunikimit. Gjithashtu, ajo paraqet një

¹⁵ Bazuar në anketimin: “FOKUS” & “Rejting”. Alsat-M (21.02.2014). Alsat-M, the most credible television in Macedonia. Mund të gjindet në: https://www.alsat-m.tv/lajme/nga_vendi/14007-alsat-m-televizioni-me-i-besueshem-ne-maqedoni.html

pjesë të trashëgimisë kulturore të njerëzimit.” (Barth O’Neill, f. 3). Pikërisht për këtë arsye ruajtja e gjuhës sonë është një e drejtë bazike që çdo kush e posedon. “Në nivel botëror traktatet dhe deklaratat ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara mbrojnë përdorimin e gjuhëve. Shumëgjuhësia dhe diversiteti gjuhësor janë parime themelore të Bashkimit Evropian. Kjo u parashtrua tek Neni 22 i Kartës Evropiane të të Drejtave Themelore. Ajo thotë: *“Bashkimi Evropian do të respektojë diversitetin kulturor, fetar, politik e gjuhësor”.*” (Barth O’Neill, f. 3)

Ndërsa sa i përket UNESCO duke u bazuar në deklaratat e kësaj organizate shumë gjuhë janë në rrezik për zhdukje. Shumë gjuhëtarë i shohim të shqetësuar për këtë çështje dhe janë po ata që mundohen të promovojnë gjuhën e tyre sidomos tek fëmijët që jetojnë në mërgim dhe nuk kanë shumë kontakt me gjuhën amtare dhe kjo e bënë më të vështirë për këto fëmijë të kenë interes të komunikojnë në gjuhën e nënës së tyre. E sigurisht nëse asgjë nuk ndryshohet, me shumë gjasë shumë gjuhë do të zhduken ashtu siç ka deklaruar edhe Unesco. “Nëse gjuhët e pashkruara dhe jo të dokumentuara do të zhduken kjo do të thotë se jo vetëm që do të humbasë njerëzimi pasurinë e tyre kulturore, por gjithashtu do të humbasë njohuritë e rëndësishme e paraardhësve të saj, veçanërisht në rajon dhe gjuhët pakicë dhe gjuhët e njerëzve vendas.” (Barth O’Neill, f. 4). Kjo është shumë e rëndësishme për shkak se çdo gjuhë në botë është e veçantë dhe asnjë gjuhë nuk mund të thuhet se ka më pak ose më shumë rëndësi se një gjuhë tjetër për shkak se çdo gjuhë ka veçantinë e saj e sidomos kur bëhet fjalë për kuptimin e metaforave, anekdotave etj.

“Atlas ka informacione për më shumë se 2,500 gjuhë të rrezikuara në mbarë botën. 200 gjuhë janë zhdukur gjatë tre gjeneratave të fundit, rreth 1,700 gjuhë janë të rrezikuara seriozisht, më shumë se 600 gjuhë mezi po përden më. Gjysma e të gjitha gjuhëve janë pakicë dhe gjuhët rajonale të folura nga më pak se 10,000 njerëz.” (Barth O’Neill, f. 4) Sipas UNESCO Atlas of the World’s Languages in Danger (gjuhët e rrezikuara)¹⁶ Maqedonia e Veriut është rrezikuar nga gjuhët që fliten në këtë vend.

4.3 Konceptet e rëndësishme të shumëgjuhësisë.

¹⁶ <http://www.unesco.org/languages-atlas/index.php>

Multilingualizmi apo shumëgjuhësia është një fenomen shumë i zakonshëm që ka marrë shumë vëmendje shkencore në vitet e fundit. "Multilingualizmi është gjithashtu një fenomen ndërdisiplinor që mund të studiohet nga perspektiva individuale dhe shoqërore" (Jasone, 2016, f. 3). Globalizimi ka rritur vlerën e shumëgjuhësisë. Duke folur më shumë gjuhë do të kemi më shumë dyer të hapura dhe të tjerët do të na vlerësojnë më shumë. Një përkufizim i mirënjohur i shumëgjuhësisë është dhënë nga Komisioni Evropian (2007): "aftësia e shoqërive, institucioneve, grupeve dhe individëve për t'u angazhuar në baza të rregullta me më shumë se një gjuhë në jetën e tyre të përditshme"¹⁷

Sa i përket koncepteve të multilingualizmit nga përshkrimi i Isabelle Barth O'Neill në librin Language Diversity – a European campaign to raise awareness for multilingualism and linguistic diversity in Europe përshkruan disa koncepte të multilingualizmit si për shembull:


- Shumëgjuhësia institucionale i referohet bashkëjetesës së disa gjuhëve brenda institucioneve.
- Multilingualizmi Social i referohet bashkëjetesës së disa gjuhëve në një shoqëri. Shumëgjuhësia sociale ka një dimension politik-gjeografik dhe një dimension social-psikologjik.
- Shumëgjuhësia individuale lidhet me shumëgjuhësinë e qenieve njerëzore. Ata janë shumëgjuhësh, pasi ata janë të aftë në më shumë se një gjuhë.
- Gjuha e Nënës...("gjuha e nënës" ose edhe "gjuha amtare") është i kuptuar përgjithësisht si gjuha e parë e personit që e ka trashëguar nga familja e tij/saj. Në disa vende, termi gjuha amtare i referohet gjuhës së një grupi etnik në vend të gjuhës së parë.
- Gjuha e Pakicave është gjuha e një pakice autoktone që e flet atë gjuhë (në rastin e gjuhës së një minoriteti, literatura zakonisht përdorte fjalën "gjuhë emigrimi").
-

¹⁷ European Commission. (2007). Final report: High level group on multilingualism. Luxembourg: European Communities. Retrieved from http://ec.europa.eu/education/policies/lang/doc/multireport_en.pdf

4.4 A duhet nxënësit të mësojnë gjuhën e njëri-tjetrit?

Should the pupils learn each other's language?

203 responses



Në pyetjen a radhës se a duhet nxënësit të mësojnë gjuhën e njëri tjetrit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në fakt përgjigjet e tyre ishin edhe të pritura. Përgjigja e përqindjes më të madhe me 70.04% ishte Po, ndërsa vetëm 18.2% mendojnë që fëmijët nuk duhet të mësojnë gjuhën e njëri-tjetrit. Disa nga të anketuarit kanë dhënë edhe përgjigje pse ata mendojnë se duhet të jetë ashtu:

- Ata mundën nëse duan, por nuk duhet të jenë të detyrueshme.
- Nuk është e nevojshme për qëllimet e mia në jetë.
- Nuk është e nevojshme, të gjithë duhet të mësojnë gjuhën zyrtare të vendit ku jetoni, por edhe dikush që dëshiron dhe ka dëshirë mund të mësojë gjuhën e etnive të tjera. Për shembull, për amerikanët në Miami nuk është e nevojshme të mësojnë spanjisht për shkak të Latinove atje, por Latinasit duhet të flasin anglisht.
- Sepse në fshatin tim ka vetëm njerëz që flasin shqip.
- Nëse ata (fëmijët) kanë kontakt me njëri-tjetrin, ata patjetër do të mësojnë gjuhën e tjetrit, ju nuk keni nevojë t'i shqetësoni me një lëndë të shtuar në shkollë.
- Gjithkush duhet të mesojë gjuhën maqedonase.
- Etnitë tjera përderisa jetojnë në Maqedoni duhet të mësojnë atë gjuhë.

- Sepse është e njëanshme maqedonasit mendojnë që çdo etni tjetër duhet të mësoj gjuhën maqedonase ndërsa ata vetë nuk mësojnë asnjë gjuhë tjetër.
- Nxënësit duhet të mësojnë anglisht, do t'i ndihmojnë ata të komunikojnë me njëri-tjetrin dhe gjithashtu me kombësi të tjera. Nëse shqiptarët do të mësonin gjuhën maqedone dhe anasjelltas, ata do të ishin në gjendje të komunikonin me vetëm një kombësi.

“A mund të më jepni një shembull të marrëdhënieve të mira/të këqija të përvojës suaj personale?” Ishte githashtu një nga pyetjet e anketës ku të anketuarit nuk kanë ngurruar të përgjigjen, ku përgjigjet e tyre variojnë më së shumti me eksperiencat e tyre negative që kanë pasur me etnitetet tjera. Në këtë pyetje janë përgjigjur 39 të anketuar. Nga përgjigjet e tyre mund të shihen shumë ekperiencia të mira por edhe të këqija, urrejtje dhe mirëkuptim. Edhe sot nëse një maqedonas sillet mirë me një shqiptar apo i kryen një shërbim ose anasjelltas neve këto sjellje përsëri na surprizojnë për mirë. Pavarësisht se këto sjellje duhet të konsiderohen si normale dhe të mos u jepet kaq shumë rëndësi. Për shembull, disa nga të anketuarit përshkruajnë përvojat e tyre qofshin ato të mira, të këqija, specifike apo të përgjithshme:

- Maqedonasit e Maqedonisë Veriore marrin pjesë në bullizëm ndaj etnive tjera që jetojnë në Maqedoni. Për shembull, nga përvoja ime personale që jetoj në Maqedoni, do të thosha se bullizmi dhe injoranca vazhdojnë edhe në institucionet ku ne kryesisht përballemi si të rritur. Disa muaj më parë kam aplikuar për një punë në një ndërmarrje suedeze këtu në Maqedoninë e Veriut, ku rekrutuesi ishte maqedonas dhe më ofroi një intervistë pune vetëm duke folur në telefon. Pas një muaji të plotë kompania ka punësuar dy maqedonas për dy pozicionet e hapura. Bëra kërkime dhe pashë se 90% e punëtorëve ishin maqedonas, 10% e tyre ishin nga etnitë të tjerë. Nëse bëjmë kërkime të hollësishme do të shohim se si etnitë e tjerë kanë mbetur prapa nga sektori privat dhe publik dhe madje nga shteti.
- Të gjithë fëmijët luajnë së bashku në një lagje të përzier pasi vijnë nga shkolla.
- Gjithmonë kam përvoja të mira me këdo. Etnia e tyre nuk do të thotë asgjë për mua.

- Zakonisht, maqedonasit e Veriut i trajtojnë keq shqiptarët në vendet e punës, ata kanë perceptime të këqija për shqiptarët dhe na urrejnë sepse ishim këtu para tyre.

- Personalisht unë kam pasur gjithmonë marrëdhënie të mira edhe pse nuk jam duke folur rrjedhshëm në gjuhën e tyre.

- Kam shumë shembuj. Më kujtohet sa i diskriminuar unë isha në shkollë fillore dhe nganjëherë edhe në shkollë të mesme. Tani nganjëherë ndodh edhe në institucionet publike për shkak të stereotipit të vjetër se romët janë të paarsimuar dhe krijesa të pista. Për fat të mirë gjërat kanë ndryshuar pozitivisht por disa stereotipe ende ekzistojnë ndaj komunitetit rom.

- Më së shumti kam shembuj pozitiv me njerëz të grupeve të tjera etnike, si maqedonasit, turqit apo edhe romët për shkak të kohës që kam studiuar në një shkollë të mesme ku kemi qenë të përzier.

- Kam dëgjuar shpesh se si maqedonasit në lagjen time kanë thënë 'smrt za siptari' (vdekje për shqiptarët).

- Përvoja e keqe nuk është personale, por është gjëja më e rëndësishme ka të bëjë me mënyrën sesi qeveria sillet ndaj shqiptarëve me 0% kthim të investimit nga tatimi, 0% në arsim, 0% në kulturë dhe padyshim 0% në çdo fushë tjetër që ka të bëjë me jetën dhe identitetin tonë të përditshëm.

- Një surprizë e përgjithshme se si "unë flas maqedonisht" nga maqedonasit në biseda të përgjithshme ose kur them se jam shqiptar se si nuk dukem si shqiptarë dhe shumë më tepër!

- Në këndvështrimin tim, vazhdojnë të ekzistojnë stereotipe dhe paragjykime megjithëse janë në shkallë më të ulët dhe pavarësisht bashkëpunimit të etnive kryesisht maqedonase ata ende kanë ndjenjën e nacionalizmit.

- Miku im më i mirë është maqedon dhe ai është njësoj si vëllai im.

- Paragjykimet e përbashkëta - fëmijët romë janë më pak të kualifikuar.

- Janë më shumë raste, do veçoja atë sentencën e njohur kur na thonin "nëse doni shqip, shkoni në Shqipëri" etj etj!

4.5 Maqedonasit dhe turqit

Turqit në Maqedoninë e Veriut në disa raste janë të njohur edhe si turq maqedonas. Pavarësisht regjistrimit në vitin 2002, shumica e turqve thonë se numri i tyre është më i lartë se 77,959. Ashtu si edhe romët edhe turqit në një periudhë kohore e kanë identifikuar veten si maqedonas dhe shqiptarë për të shmangur stigmën që është krijuar për turqit. Ndryshe nga shqiptarët turqit kanë pasur shkolla turke në Maqedoni që në vitin 1944.

Erdogan Saraç artikuloj një ide që ishte e përsëritur nga shumë Turq, kur ai u tha Human Rights Watch/Helsinki: *Është e qartë që në fillim të Kushtetutës së ata (Maqedonasit etnik) deshën të krijonin një shtet nacional. Por, në anën tjetër të Kushtetutës, ideja për Maqedoninë është të bëhet një shtet për të gjithë. Nuk është e mundur të favorizosh më shumë një nacionalitet dhe në të njëjtën kohë të kesh një shtet për të gjithë.*¹⁸

Turqit ankohen në atë mënyrë se e gjithë kjo e sipas tyre e dëmton etninë e tyre dhe kjo bën që ata të pakësohen në numër dhe të mos kenë shumë të drejta për punësim në institucione të rëndësishme. Sipas Abrahamas (1996) Human Rights Watch/Helsinki nuk tregon një numër preciz por thuhet se turqit janë të diskriminuar në aspektin e punësimit në shtet.

Afrim Samovski, një turk i cili jeton në Dibër, dha një intervistë për Human Rights Watch/Helsinki ku thoshte se: Unë punoj në Ministrinë e Drejtësisë në Dibër. Zyra ime ka shtatë njerëz dhe të gjithë përveç meje janë maqedonas etnik. Në të gjithë ndërtesën janë të punësuar rreth 100 vetë, unë jam turku i vetëm.¹⁹

Intervista e Samovskit tregon atë çka u përmend edhe më herët për pa mundësitë e punësimit të këtij komuniteti. Një rol negativ të rëndësishëm këtu luan edhe mos pasja e shkollave në gjuhën turke në nivelin e duhur. Turqit gjithmonë ankohen se ka shkolla fillore turke por shumë pak shkolla të mesme ku edhe kriteret për një shkollë të mirëfilltë nuk plotësohen. Abrahamas (1996) thotë që Ministra e Arsimit i ka hedhur poshtë këto pohime të turqëve ku edhe duke i fajësuar ata që nuk e flasin mirë gjuhën e tyre. Sot, shumë turq flasin maqedonisht për shkak të mundësive të pakta që atyre u ofrohen.

¹⁸ Human Rightw Watch/Helsinki intervistë me Erdogan Saraç, Shkup, Gusht, 8, 1995

¹⁹ Human Rightw Watch/Helsinki intervistë me Afrim Samovski, Zhupa, Korrik, 30, 1995


Pavarësisht kësaj, turqit janë munduar shumë që të kenë kushte më të mira. Për shembull, ata kanë tentuar edhe të hapin shkolla turke private në vitin 1991 por sipas Abrahams (1996) për të hapur shkolla në gjuhën oficiale turke është refuzuar për shkak se sipas Ministrisë së Edukimit të atëhershme në Dibër këto dy shkollat u konsideruan si ilegale. Ku në bazë të asistentit të atëhershëm të Ministrisë së Edukimit, shumë turq nga rrethi i Zhupës nuk flasin turqisht e si pasojë e kësaj ata nuk kanë nevojë për një shkollë turke sepse ata janë maqedonas myslimanë që hiqen si turq pavarësisht se çdo njëri prej tyre në këtë rreth shoqëror deklarohet se është një turk i vërtetë dhe se ska asnjë rrënjë maqedonase. Pavarësisht se ata e dinë gjuhën maqedonase nuk duhet t'u merret e drejta të edukohen në gjuhën që ata dëshirojnë dhe e konsiderojnë të veten. Ky është një diskriminim dhe një torturë për turqit dhe fëmijët e tyre se ato dy shkolla private janë mbyllur me dhunë dhe janë djegur apo shkatërruar me gjithë çka pasur brenda. Ku në një intervistë tjetër për Human Rights Watch/Helesinki të vitit 1995 Baudin Sacir në rrethin e Zhupës tregon ngjarjen e vërtetë të dy shkollave. Ai thotë: Në 8 korrik, në orën 6:30 të mëngjesit, 250 policë erdhën me armë dhe bllokuan të gjitha rrugët. Ishte shumë e paretshme, ishte si një lloj okupimi. Nxënësit ishin në rrugë dhe ishin të kërcënuar nga policia. Policët u thanë fëmijëve se ata nuk mund të shkonin në shkollë dhe duhej të ktheheshin tek shtëpitë e tyre. Për dy orë, shkollat ishin shkatërruar nga policët me gjithçka ka pasur brenda tyre. Ato (policët) ikën në ora 9:00. Në ora 11:00 UNPROFOR (Forca e Mbrojtjes e Kombeve të Bashkuara) erdhën për të kontrolluar. Ata erdhën për tre ditë rresht për të marrë intervista.²⁰ Pavarësisht protestave dhe demonstratave të turëve në fund asgjë nuk u arrit. Protestat nuk ishin të dhunshme edhe pse policët ishin prezent. Sigurisht, pozicioni i Human Rights Watch/Helesinki nuk është ta obligojë shtetin maqedonas për të hapur shkolla në gjuhën turke. Por, Human Rights Watch/Helesinki beson se shteti duhet t'i lejojë qytetarët për të hapur shkolla private sepse kjo është një e drejtë themelore kur kemi të bëjmë me grupe të vogla të një shteti, e drejta për të shijuar kulturën e tyre. Përveç kësaj turqit ndihen të diskriminuar më shumë nga të tjerët sepse edhe mediat e maqedonisë nuk japin shumë programe në gjuhën turke. Në pyetjen se si turqit i shohin shqiptarët, maqedonasit dhe romët që jetojnë në Maqedoninë e Veriut, është ndryshe nga ajo çka kemi dëgjuar ne shumë shpesh. Në bazë të hulumtimit të

²⁰ Human Rights Watch/Helsinki intervistë me Baudin Sacir, Zhupa, 29 Korrik 1995. OSBE gjithashtu vizitoi vendin

anketës dalim në përfundim se turqit nuk kanë edhe aq marrëdhënie të vështira me shqiptarët sepse përqindja më e madhe e turqëve mendonjë se shqiptarët janë të besueshëm por në anën tjetër janë edhe nacionalista. Ndërsa, për maqedonasit ata me përqindje më të madhe kanë votuar se maqedonasit janë nacionalistë, ndonjëherë të besueshëm ndonjëherë e kundërta. Turqit me përqindje më të madhe kanë thënë se maqedonasit janë nacionalista sepse mendojnë që ata duan që gjithçka të kenë për vete dhe gjithmonë të jenë të parët. Ku edhe në bazë të përshkrimit të historisë së mbylljeve të dy shkollave, tregon që maqedonasit janë nacionalistë e diskriminues ku duan sa më shumë turq të deklarohen se janë maqedonas. Kjo ka bërë që turqit që janë më pak të integruar në shoqëri dhe janë shumë të varfër, ka qenë më e lehtë për to të deklarohen se janë maqedonas. Por, për pjesën tjetër kjo ka nxitur një lloj urrejtjeje për maqedonasit dhe përveç arsyeve tjera kjo ka qenë më e rëndësishmja pse ata i konsiderojnë maqedonasit si nacionalista.

Ndërsa sa i përket marrëdhënies së romëve dhe turqve asnjëherë nuk ka qenë shumë të komplikuar në këtë territor sepse ata gjithmonë e kanë parë njëri-tjetrin si etni të ndarë dhe shumë të diskriminuar. Por, kjo nuk do të thotë se romët i kanë ikur të gjitha stereotipeve

How do Turkish people see these ethnicities?




dhe paragjytimeve nga turqit sepse në bazë të anketës tregon se turqit mendojnë që romët janë njerëz që genjejnë, që vjedhin, të besueshëm dhe shumë pak nacionalistë.

4.6 Maqedonasit dhe shqiptarët

Një studim shumë të rëndësishëm në këtë drejtim ka bërë autori Rober Pichler nga Universiteti Humboldt i Berlinit, ku paraqet pikëpamjet e tij mbi zhvillimet shoqërore në Maqedoninë e Veriut, ku ai kishte kaluar shumë kohë duke studiuar shoqërinë. “Fokusi i tij qëndron në ndërveprimet midis shqiptarëve dhe maqedonasve dhe për të analizuar origjinën e paragjytimeve. Ai i lidh paragjykimet me historinë dhe zhvillimin ekonomik. Konflikti dhe ndarja kanë origjinën komuniste përmes vendbanimeve rurale dhe urbane. Kjo krijon një shoqëri të ndarë, ku njerëzit jetojnë jetët e ndara nga njëri tjetri. Ai thotë: Maqedonasit janë më mirë të integruar në mjediset urbane, kurse shqiptarët vendosen në fshatra dhe punojnë në sektorin bujqësor. Shqiptarët nuk ndihen sikur janë pjesë e shoqërisë dhe janë më pak të integruar. Ata gjithashtu ndryshojnë në demografi, pasi ata kanë më shumë fëmijë.

How do Macedonians see these ethnicities?




Maqedonasit mendojnë se shqiptarët zënë vendin e tyre, se ata janë kriminelët të pasur dhe kanë agjenda të fshehura. Shqiptarët e shohin Maqedoninë si një komb artificial, që nuk e di kush flet dhe politikanët e të cilit janë moralisht inferiorë. Ata nuk ndihen të mirëpritur dhe mendojnë se maqedonasit janë me dy fytyra. Ata diskriminojnë shqiptarët në vendin e tyre.”²¹

²¹ Trajnim: Pichler Robert, *Prejudices and Political Instrumentalisation in the Balkans Status Quo and Future Prospects 20 Years After Dayton*, Nëntor 2015

Për këtë arsye maqedonasit edhe në anketë i shohin shqiptarët me një përqindje shumë të madhe si nacionalistë por edhe të pabesueshëm. Historia e këtyre dy marrëdhënieve nuk është e vështirë për të kuptuar pse nacionalizmi mes tyre sa vjen e më shumë rritet. Shumë pak nga maqedonasit mendojnë se shqiptarët janë të besueshëm apo gënjeshtar. Ndërsa mendimet nuk i kanë të njëjta për etninë romë dhe turqit. Për shembull, turqit i shohin si shume pak nacionalist por shumë të besueshëm, romët si njerëz të pa pastër, gënjeshtarë dhe aspak nacionalistë. Ndërsa sa i përket shqiptarëve, ata pothuajse ndajnë të

How do Albanian see these ethnicities?



njëjtën mendim për maqedonasit, ku me përqindje më të madhe i shohin si nacionalista dhe jo të besës. Kjo nuk ka asnjë dallim kur krahason me analizën e autorëve që kemi përmendur në këtë hulumtim.

4.7 Maqedonasit dhe romët

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, popullsia rome është një komunitet që paraqet një përballje me etnitë tjera kundrejt paragjyqimeve, stereotipeve dhe diskriminimit shoqëror apo institucional.

“Ka rreth 54,000 romë në Maqedoni (një pjesë e statistikave të diskutueshme si deklarimi i identitetit të romëve mund të jetë mjaft i paqartë). Prej tyre, 17,000 janë të papunë dhe 14,000 nuk mund të përballojnë nevojat themelore. Një tjetër statistikë thotë se 85% e

romëve në Maqedoni marrin ndihmë sociale” (Karajkov, 2005). Por, në bazë të këshillit të Evropës, mendohet se romët arrijnë rreth 135,000 deri në 240,000.²²

Shumica dërrmuese e romëve janë myslimanë dhe flasin kryesisht gjuhën e tyre. Por, ndodh shpesh që ata të flasin gjuhën maqedonase, shqipe ose atë turke, kur e përdorin si gjuhë të dytë. Marrëdhënia e romëve dhe maqedonasve nuk ka qenë aq e komplikuar se ajo e shqiptarëve. Romët janë besnikë ndaj maqedonasve për disa të drejta që u ofrohen. Kjo është për shkak se të drejtat e pakicave të tyre përgjithësisht konsiderohen të jenë shumë më të gjera se ato të të afërmeve të tyre në shtetet e tjera të Ballkanit.²³

Raporti i Komisionit Evropian për progresin e Maqedonisë për vitin 2010, thekson se diskriminimi i policëve ndaj romëve është teje i madh, ku ndodh të ketë edhe sjellje brutale. Gjithashtu, thekson se edhe Agjencia për mbrojtjen e të drejtave të bashkësive të përfaqësuara me më pak se 20% nga popullata nuk është ende funksionale. Ish-këngëtarja e famshme romë Esmë Rexhepova në një intervistë për DW thotë: “Unë jam zëvendës-presidente e Organizatës Botërore të Romëve, (IRU). Kur bëhen kongrese të gjithë më thonë. „Sa fat keni ju romët në Maqedoni.“ Është e vërtetë që vetëm në Maqedoni romët janë të njohur me kushtetutë si grup etnik. Modelin tonë duhet ta adoptojnë edhe vendet e tjera” (Blaževska & Verbica, 2013). Pavarësisht kësaj se romët janë të njohur me kushtetutë në Maqedoni përsëri statistikat e papunësisë tregojnë që është shumë e vështirë që romëve tu njihet e drejta bazike themelore për jetesë.

"Problemi më i madh është regjistrimi i vonuar i fëmijëve romë dhe fakti që shumë prindër nuk i regjistrojnë fëmijët e tyre në arsimin fillor, atëherë është shkalla shumë e lartë e braktisjes", thotë Dragan Nedelković nga organi qeveritar për arsimin e pakicave. Maqedonasit paragjykojnë shqiptarët sepse mendojnë që këto të fundit mundohen t'i bindin romët “që të deklarojnë veten e tyre si Shqiptar” (A conflict analysis - Macedonia, 2003, f. 29) dhe me këtë bindje për të rritur numrin e shqiptarëve si popullsi, ku pas kësaj vijon edhe kërkimi i më shumë të drejtave nga ana e shqiptarëve. Pavarësisht kësaj romët në një formë apo në një tjetër ndihen të diskriminuar dhe të paragjykuar më shumë se grupet tjera etnike në

²² Këshilli i Evropës, ‘Dokument i përgatitur nga Ekipi Mbështetës i Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për Çështjet e Romëve’, korrik 2012.

²³ Intervistë e marrë nga: <https://www.balcanicaucaso.org/eng/Areas/North-Macedonia/Roma-in-Macedonia-A-Decade-of-Inclusion-29319>

Maqedoninë e Veriut. Për shembull, “thuhet se romët kanë vështirësi në marrjen e licencave të biznesit” (A conflict analysis - Macedonia, 2003, f. 30).

Një problem tjetër është edhe regjistrimi nëpër shkolla fillore, ku romët shohin mangësi në këtë aspekt sepse ata nuk kanë mundësi të përballojnë shkollimin. Por, nëse ata shkojnë në shkollë ata do t’i ndjekin mësimet në gjuhën maqedonase, shqipe ose turke sepse ata në shtëpi flasin një nga këto gjuhë dhe sigurisht që fëmijët e kanë më lehtë të ndjekin shkollimin në gjuhën që ata flasin në shtëpi. Për shkak të mangësisë të ofrimit shkollim në gjuhën e tyre amtare, ata ndihen të diskriminuar sepse në këtë mënyrë e harrojnë gjuhën e vetë amtare dhe në një mënyrë janë të obliguar të flasin më së shpeshti gjuhën turke.

Përshkak të paragjyqimeve të tepërta dhe diskriminimeve që u bëhen romëve, ato në një periudhë kohore kërkuan azil në vendet e BE-së dhe kjo ishte periudha kur u bë liberalizimi i vizave në vitin 2009. “Pjesa dërrmuese e njerëzve që e braktisën Maqedoninë për të jetuar në shtetet e jashtme, kryesisht në Gjermani, Francë, Belgjikë, Holandë dhe Suedi, ishin romë.” (Spitálszky, 2018), Por, shumica e azil këkuesve janë refuzuar dhe të gjithë ata që kanë bërë kërkesën për azil janë kthyer në shtetin e tyre. Ata nuk ndihen të paragjykuar vetëm nga sistemi politik e ekonomik por edhe në çdo pikëpamje tjetër. “Një numër i caktuar incidentesh janë evidentuar lidhur me parandalimin e romëve për të hyrë në restorante, kafene, bare, diskoteka, pishina ose hotele për shkak të një llojllojshmërie të arsyeve të rreme: për shembull, iu thonë se po organizohet një ngjarje private ose se kanë nevojë për rezervim, madje kur edhe hapësirat janë të zbrazura” (Spitálszky, 2018).

Pothuajse, të gjithë etnitë mundohen t’u rrinë larg romëve për shkak të stereotipeve që ata kanë për romët. Ekziston edhe ajo ide se nëse një shqiptar ose maqedonas shoqërohet me një rom atëherë atyre etnive u humbet reputacioni në shoqërinë që ata kanë krijuar. Në këtë mënyrë këto përjetime kanë efekte të fuqishme negative mbi vetëbesimin e tyre në shoqëri. Romët para se të marrin një hap për t’u integruar në shoqërinë maqedonase ose shqiptare, ata e mendojnë shumë gjatë se si do të priten dhe çfarë pasojash do të kenë. Pavarësisht se diskriminimi është i ndaluar me ligj, romët çdo ditë e më shumë ballafaqohen me paragjyqime dhe diskriminime.

Kushtetuta e Maqedonisë²⁴ dhe Ligji për Arsimin Fillor²⁵ e garanton të drejtën për arsim nën kushte të barabarta. Por, pavarësisht se e drejta për arsim është e barabartë për të gjithë, romët janë në një përqindje shumë të madhe që nuk shkojnë fare në shkollë ose shkojnë deri në vitin e katërt të shkollës fillore pastaj e ndërpresin. Sigurisht kjo ndodh për disa arsye. Një nga arsyet është për shkak se prindërit e fëmijëve romë nuk janë të regjistruar, pra nuk posedojnë asnjë dokument se ata janë shtetas maqedonas dhe si pasojë ata nuk mund të regjistrojnë as fëmijët e tyre. “Romët nganjëherë ndalohen të regjistrohen ose nuk kanë njohuri të plotë për të drejtat e tyre të garantuara me ligj” (Spitálszky, 2018). Një arsye tjetër është segregimi apo izolimi nga shoqëria që ka një impakt të madh tek fëmijët, një problem tjetër që shfaqet është edhe mungesa e transportit nga vendbanimet romë deri tek shkolla që ata janë të regjistruar. Për më tepër, prindërit e fëmijëve romë janë shumë të varfër dhe mospasja e mjeteve të mjaftueshme bën edhe më të vështirë shkollimin. Thuhet edhe se vetë prindërit e fëmijëve romë nuk kanë dëshirë për t’i regjistruar fëmijët e tyre nëpër shkolla, zakonisht vajzave më të mëdhaja u thuhet që të kujdesen për punët e shtëpisë ose për motrat e vëllezërit më të vegjël. Për të mos mjaftuar vetëm këto, fëmijët romë që shkojnë në shkollë, shpesh janë të detyruar të ulen nëpër bankat e fundit, e kjo ndodh vetëm për shak të paragjytimeve dhe stereotipave që fëmijët e etnive tjerë kanë për romët. Ndërmjetësit romë raportojnë se paragjykimet nuk vijnë vetëm nga nxënësit e tjerë por edhe nga mësuesit, ku në këtë mënyrë nxënësit mund ta shprehin urrejtjen e tyre edhe më lirshëm.

“Problem me ndjekjen e mësimi të rregullt në gjuhën maqedonase paraqitet në rajonin e Shkupit-Kumanovës, për shkak se nxënësit romë në familjet e tyre e flasin gjuhën e tyre amtare romë. Këta fëmijë kur nisin në klasën e parë kanë vështirësi të mëdha në kuptimin dhe ndjekjen e mësimi në gjuhën maqedonase, pasi që shumë dobët ose aspak nuk e njohin gjuhën e njëjtë” (Poposka, 2010, f. 106). Për shkak se nuk ka mundësi bazike në shkollim për romët, në të ardhmen pritet që të hapen katedra ose grup studimi në gjuhën romë dhe gjithashtu nëse kjo mundësi nuk realizohet duhet tu ofrohen bursa të paktën për të studiuar në Universitetet rajonale, të cilat ofrojnë studimet në gjuhën romë. Në këtë rast do të

²⁴ Neni 44, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë: ‘Çdonjëri ka të drejtë për arsim. Arsimi është i qasshëm për çdonjërin me kushte të barabarta. Arsimi fillor është i detyrueshëm dhe falas.’

²⁵ Ligji për Arsimin Fillor, Fletorja Zyrtare nr. 103/08, 2008.

rregullohen apo mundësohet që komuniteti romë do të realizojë të drejtat e vet të garantuara kushtetuese për mësimin në gjuhën amtare.

Një studim i UNICEF-it për gratë romë dhe fëmijët deklarojnë se 97.7% nuk kanë punë të rregullt. E kjo vjen si pasojë edhe mos shkollimit. Vetëm 11 për qind e romëve kanë mbaruar shkollën e mesme, krahasuar me 60 për qind të popullsisë së përgjithshme, sipas Fondacionit të Shoqërisë së Hapur. Ndërsa sipas Katerina Blaževska dhe Angjelina Verbica (2013) në një artikull për DW thonë që niveli i papunësisë në Maqedoni është rreth 30%, ku tek romët arrin rreth 90%. Po të bësh një krahasim me grupet tjera etnike në Maqedoninë e Veriut, analfabetizmi është më i lartë tek romët sesa tek grupet tjera, por gjithsesi kjo vitet e fundit ka një lloj përmirësimi.

Spitálszky (2018) në hulumtimin e tij për romët jep disa rekomandime se si arsimit tek romët mund të përmirësohet:


- Të zhvillohen politika shtetërore për të avancuar vijimin e mësimin parashkollor në mesin e romëve dhe për të ngritur ndërgjegjësimin rreth rëndësisë së tij në mesin e prindërve.
- Të zbatohet një strategji që në mënyrë efikase të përballohet norma e lartë e braktisjes së shkollimit të mesëm, të cilat do të shtrihen përtej masave ndëshkuese si gjoha të prindërit për motivimin aktiv të fëmijët romë për të vijuar mësimin shkollor.
- Të vlerësohet numri i fëmijëve romë në zonat e mbulimit të çdo shkolle dhe të sigurohet shpërndarja e tyre e barabartë me fëmijët jo romë.
- Të sigurohet zbatimi i plotë i mundësive për studentët romë për të studiuar gjuhën dhe kulturën romë si lëndë zgjedhore, në pajtim me dispozitat ligjore mbi arsimin.
- Të ndryshohet Neni 156 i Ligjit për Arsimin Fillor që të thjeshtësohet njohja e dëftesave të fituara në shkolla të huaja nga fëmijët që kthehen nga vendet e jashtme. Për më tepër, të hiqet pagesa e tarifës administrative për ato familje që nuk mund të paguajnë ato tarifa për njohjen e dëftesa të shkollave të huaja.
- Të futet një komponentë për mosdiskriminim dhe trajtim të barabartë në plan programet e mësimdhënësve. Përfundimi i shkollimit të bëhet i detyrueshëm për të pranuar me sukses dëftesën e mësimdhënësit.

- Të rishikohen materialet mësimore dhe plan programi për të siguruar mospërfshirjen e stereotipave negative. Nëse është e nevojshme, të përpilohen materiale të reja që e avancojnë trajtimin e barabartë të romëve dhe minoriteteve tjera.

Përveç problemeve me arsimin, romët gjithashtu përballen me problemet e sistemit të shëndetësisë. “Romët në Maqedoni kanë një jetëgjatësi 10 vjet më të shkurtër se gati 76 vjet e mesatares maqedonase. Shumë nuk mund të kenë akses në kujdesin shëndetësor për shkak të paragjytimeve dhe mungesës së dokumentacionit” (Hopkins, 2017). Kushtetuta e Maqedonisë e garanton të drejtën për shëndetësi për të gjithë qytetarët²⁶ Sa i përket romëve në Maqedoninë e Veriut dhe shëndetësisë së tyre. Pavarësisht se e mbrojtur me ligj, përsëri ata përballen me diskriminim për shkak se ky lloj denoncimi edhe sot në një masë shumë të madhe mbetet i pa denoncuar. Mos denoncimi i diskriminimit në arsim ose në shëndetësi ndodh për shkak se romët ende nuk e dinë çfarë të drejtash posedojnë si qytetarë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Pra, shumicës së tyre u mungon ky informacion dhe kjo i bën që ata gjithmonë të stepen përballë diskriminimeve që u bëhen. Ndërsa një arsye tjetër është se ata që kanë informacion për ligjin që i mbron të drejtat e tyre, janë pikërisht ata romë që nuk besojnë se ky ligj mund të zbatohet në praktikë. Përveç pengesave kulturore ekzistuese, ndërmjetësit romë thonë që kanë paragjytime edhe në situatat më kritike. Për shembull, ka pasur raste kur gratë shtatzanë kanë lindur nëpër korridore të spitaleve ose në shtëpitë e tyre për shkak se nuk u është lejuar të bëjnë lindje normale. Ka shume raste të ngjashme që ende nuk bëhet zë për to, por që ekzistojnë. Duke marrë parasysh që këto sjellje ndikojnë tek romët, ata nuk kanë vullnet për të kërkuar kujdes shëndetësor, e kjo sigurisht rezulton në rezultate shëndetësore të dobëta. Ndërsa në tabelën më poshtë shohim që maqedonasit dhe romët nuk kanë mendime edhe aq të ngjashme për njëri-tjetrin. Për shembull, romët mendojnë se maqedonasit janë nacionalistë por në anën tjetër edhe të besueshëm. Ndërsa shohim se romët kanë marrëdhënie jo edhe aq të mira me shqiptarët ku një pjesë e madhe prej tyre mendojnë se shqiptarët janë të besueshëm por një pjesë tjetër

²⁶ Neni 39, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë: ‘Çdo qytetari i garantohet e drejta për përkujdesje shëndetësore. Qytetarët kanë të drejtë dhe obligim ta mbrojnë dhe avancojnë shëndetin e tyre dhe shëndetin e të tjerëve.’

How do Roma people see these ethnicities?



mendojnë të kundërtën. Në anketë mund të shohim se romët më mirë shkojnë me turqit sesa me etnitë tjera. Ku ata mendojnë se turqit janë shumë te besueshëm e jo shumë nacionalistë.

KREU 5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

5.1 Konkluzioni

Rezultatet nga hulumtimi i anketës, tregojnë se stereotipet dhe paragjykimet e etnive në Maqedoninë e Veriut ende ekzistojnë. Komunikimi është një element, i cili ndikon drejtpërdrejt se si ne e përçojmë mesazhin dhe se si ky mesazh interpretohet nga pala tjetër. Shpeshherë kuptojmë që kur këto njerëz të etnive të ndryshme të komunikojnë me njëri tjetrin ata shpesh kanë një tendencë për t'i keqkuptuar mesazhet e marra. Mënyra e funksionimit të mediave dhe portaleve lë hapësirë për t'i keqpërdorur lajmin e vërtetë dhe ta marrim në konsideratë atë që nuk është lajm i vërtetë dhe që nuk vjen nga asnjë burim i mirëfilltë. Kjo bën që të priremi më shumë rreth stereotipeve dhe paragjykimeve pa menduar fare se ato janë thjeshtë urrejtje të bazuara në qëllime politike dhe mediatike.

Maqedonia e Veriut ka treguar që diversiteti kulturor jo gjithmonë ka kuptimin e bashkëjetesës etnike në paqe. Stereotipet dhe paragjykimet me ndikimet e tyre më së shumti negative, në shoqërinë maqedonase kanë qenë prezente për shekuj me rradhë, si pjesë e pandashme të Ballkanit Perëndimor e sidomos në shtetin e Republikës të Maqedonisë së Veriut ku gjithmonë ka munguar një bashkëjetesë e mirëfilltë mes popujve etnike që jetojnë në këtë shtet.

Ky punim tregon që qytetarët e Maqedonisë së Veriut nuk kanë treguar asnjë progres për mënjanimin e paragjykimeve dhe stereotipeve mes veti, atëherë ajo çka pritet të ndodh

është ndarja edhe më e madhe mes etnive që jetojnë në këtë shoqëri dhe një bashkëjetesë më të vështirë dhe mbi të gjitha vështirësi për të marrë mbështetje apo suport nga Bashkimi Evropian. Politikanët dhe qytetarët duhet të kenë parasysh që ideja e Bashkimit Evropian është për paqe dhe bashkëjetesë të mirëfilltë jetësor.

5.2 Rekomandime

Bibliography

Blaževska, K., & Verbica, A. (2013). *Integrim në vend të getoizimit - Romët në Maqedoni*. Online: <https://www.dw.com/sq/integrim-n%C3%AB-vend-t%C3%AB-getoizimit-rom%C3%ABt-n%C3%AB-maqedoni/a-17176329>.

A conflict analysis - Macedonia. (2003). Stockholm: Swedish International Development Agency.

Abrahams, F. (1996). *A Threat to 'Stability': Human Rights Violations in Macedonia*. Printed in the United States of America: Library of Congress Catalog Card Number: 96-77111.

Active.All. (n.d.). *Guidelines for the elimination of stereotypes, and strengthening of gender equality*. Slovenia: The Ministry of Labour, Family, Social Affairs and Equal Opportunities.

Allport, G. (1958). *The Nature of Prejudice*. Addison-Wesley, Cambridge, MA.

Barth O'Neill, I. (n.d.). *Language Diversity – a European campaign to raise awareness for multilingualism and linguistic diversity in Europe*. FUEN.

Beshka, P. (2009). *Multikulturalizmi dhe marrëdhëniet ndëretnike në arsim*. Shkup: Qendra për të drejta të njeriut dhe zgjidhje të konflikteve - UNICEF.

Brunnbauer, U. (2004). *Fertility, families and ethnic conflict: Macedonians and Albanians in the Republic of Macedonia, 1944–2002*, *Nationalities Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity*, 32:3, 565-598. London: Routledge.

Burdiak, V. (2010). *Influence of ethnic stereotypes on the development of political relations in the Balkans*. nga http://www.codru_net/CC16/2/stereotypes.pdf.

De Rapper, G., & Sintès, P. (2015). *Të emërtosh dhe të klasifikosh në Ballkan*. Francë: Fjala Publishing.

Frckoski, L. (1998). *Modelot na megjuetnic`kite odnosi vo Makedonija – Model of the multiethnic relations in Macedonia*. Skopje: Krug.

Gulevska, V., Mehmedi, L., & etj. (2015). *Pikëpamje teorike dhe praktike për zbatimin e integritetit ndëretnik në fakultetin për arsimtarë*. Skopje: QMEQ në suazat e Projektit të USAID-it për Integrimin Ndëretnik në Arsim.

Hopkins, V. (2017). *Shutka: Inside Macedonia's only Roma-run municipality*. Online: <https://www.aljazeera.com/indepth/features/2017/04/shutka-life-world-roma-run-municipality-170406133010977.html>.

Ildrizi, V. Z. (2017). *Multikulturalizmi në arsim*. Qendra për mirëkuptim dhe bashkëpunim institucional -QMBI.

Janevska, J. (n.d.). *Students in FYR Macedonia build a multi-ethnic future*. MDGIF <http://www.mdgfund.org/node/3223>.

Jasone, C. (2016). *Defining Multilingualism*. Research Gate.

Jhangiani, R. (2012). *Stereotypes, Prejudice, and Discrimination*. Pressbooks.

Josifovski, I. (1974). *Opshtestvenite Promeni na Selo: Makedonskoto Albanskoto i Turskoto Naselenie na Selo vo Polog: Socialishka Studija*. Skopje: Institute of Sociological, Political and Juridical Research.

Karajkov, R. (2005). *Roma in Macedonia: A Decade of Inclusion?* Skopje: <https://www.balcanicaucaso.org/eng/Areas/North-Macedonia/Roma-in-Macedonia-A-Decade-of-Inclusion-29319>.

Katz, D., & Braly, K. (1933). *Racial stereotypes in one hundred college students*. Journal of Abnormal and Social Psychology.

Klaudjo, K. (2017). *European Journal of Education Studies*. University of Amsterdam, Department of Child Development and Education Netherlands.

Koppa, M.-E. (2001). *Ethnic Albanians in the former Yugoslav republic of Macedonia: Between nationality and citizenship, Nationalism and Ethnic Politics, 7:4, 37-65, DOI: 10.1080/13537110108428644*. 'Panteion' University of Athens, Published online: 24 Dec 2007.

Lippmann, W. (1922). *Public opinion*. New York: Harcourt Brace.

Mandaci, N. (2007). *Turks of Macedonia: The Travails of the "Smaller" Minority*. <http://dx.doi.org/10.1080/13602000701308798>.

Muhic, M. (2017). *Intercultural education in the Republic of Macedonia: An arena of conflicting narratives*. Bari: International Conference RCIC'17.

Musai, B. (2011). *Edukimi Mediatik*. Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias.

Ndrio, K. (2015). *Multikulturalizmi dhe media shqiptare në Maqedoni: modelet moderne globale dhe problematika lokale*.

Nefotistos, V. P. (2008). *The Balkans' Other within": Imaginings of the West in the Republic of Macedonia, History and Anthropology*. Online.

Nefotistos, V. (2004). *Beyond Stereotypes: Violence and the Porousness of Ethnic Boundaries in the Republic of Macedonia, History and Anthropology, 15:1, 1-36, DOI: 10.1080/027572004200191046*.

Niemann, Y. F., & Secord, P. (1995). *Social ecology of stereotyping*. Journal for the Theory of Social Behavior.

Oschlies, W. (2004). *Makedonien 2001–2004: Kriegstagebuch aus einem friedlichen Land*. Berlin: Xenomos.

Poposka, Z. (2010). *Diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike*. Shkup: Organizatuon for Security and Co-Operation in Europe.

Popova, K. (2015). *Stereotipat dhe paragjykimet në lëmin e arsimit*. Shkup: Doracaku: Pikëpamje teorike dhe praktike për zbatimin e integritit ndëretnik në fakultetet për arsimtarë.

Poulton, H. (1995). *Who are the Macedonians?* Bloomington: Indiana University Press.

Ramet, S. (2009). *Thinking about Yugoslavia Scholarly Debates about the Yugoslav Breakup and the Wars in Bosnia and Kosovo*. Cambridge University Press.

Rossos, A. (2008). *Macedonia and the Macedonians*. Hoover Institution Press Publication No. 561.

Schneider, J. (2004). *The Psychology of Stereotyping*. New York: The Guilford Press.

Spitálszky, A. (2018). *Romët në Republikën e Maqedonisë: Sfidat dhe Pabarazitë në fushën e Strehimit, Arsimit dhe Shëndetësisë*. Organizata 'Minority Rights Group International (MRG)'.

Todorova, M. (1997). *Imagining the Balkans*. Oxford University Press.

Turbedar, E. (2019). *Ballkani dhe arratisja nga identiteti ballkanik*. Online: <http://www.ekonomia-ks.com/?page=2,9,372584>.

Will, K. (2012). *Multiculturalism: Succes, failure, and the future*. Queen's University.

Xhafer, A. (2001). 'Makedonien zwischen Ethnozentrismus und Multiethnie', in Walter Kolbow and Heinrich Quaden (eds.), *Krieg und Friede auf dem Balkan Makedonien am Scheideweg?* Baden-Baden: Nomos Verlagsgesellschaft.

Zguri, R. (2015). *Paragjykimet dhe stereotipet në bazë nacionaliste në median shqiptare*.